

# KALLARATI



Ec ngado, Kallaratin mos e harro!

ORGAN PERIODIK I SHOQATËS K / A "KALLARATI"  
Viti i 20-të i botimit, nr. 109, Janar - Mars 2023  
Çmimi 50 L, Websajt: www.kallarati.com;

E-mail: gazetakallarati@yahoo.it  
Kryeredaktor: Lefter Hysaj



## GËZUAR 7 MARSIN, "DITËN E MËSUESIT"

7 Marsi është një ditë e veçantë, ku të gjithë ne përulemi me respekt e mirënjohje përpara veprës Suaj të ndritur. Ju misionarë të njerëzimit që asnjëherë nuk u lodhët në përhapjen e diturisë, sot meritoni admirimin dhe dashurinë e gjithë botës. Si kryesi e shoqatës na jepet rasti që sot t'ju drejtohem me një kartolinë urimi të gjithë mësuesve kallaratas ndër vite e t'ju themi, se keni qenë, jeni dhe do të mbeteni ata që përhapni rreze drite e diturie, rreze dashurie e atdhedashurie...

Faqe 12



"ZËRI QË THEU QELQET E QIELLIT" MBASDITE HOMAZHINË KUJTIM TË NJËVJETORIT TË NDARJES NGA JETA TË BILBILIT TË LABËRISË, BIRIT TË KALLARATIT, HYSO BALIL XHAFERAJ



Faqe 10

# 12 JANAR 2023

## NË VLORË U FESTUA 20 - VJETORI I KRJIMIT TË SHOQATËS "KALLARATI"



Faqe 2-3

AFTËSITË PROFESIONALE  
DHE VLERAT E LARTA  
MORALE E QYTETARE  
E BËJNË MËSUESIN TË  
VLERËSUAR NË SHOQËRI

Intervistë me mësuesin e  
përgjeshëm të matematikës,  
kallaratasin, Hasan Mehmetaj



Hasan Mehmetaj, lindur në Kallarat në vitin 1953 nga prindërit Boço e Venetike Mehmetaj, i rritur mes vuajtjesh dhe sakrificave si gjithë fëmijët e atij brezi, dashurinë e pasionin për dije do ta shfaqte që në vitet e para të fëmijërisë së tij. Hasani është një nga katër nxënësit kallaratas...

Faqe 4

SHOQATA "KALLARATI"  
FESTOI NË TIRANË 80 -  
VJETORIN E GJUHËTARIT  
TË NJOHUR, PROFESOR  
RAMI MEMUSHAJ

Faqe 8



**M**ë 15 Janar 2023 shoqata atdhetare e kulturore "Kallarati" festoi në Vlorë 20 - vjetorin e krijimit të saj. Në këtë veprimtari morën pjesë shumë anëtarë të shoqatës, ardhur nga Kallarati, Fieri, Durrësi, Tirana e patjetër ata që jetojnë në Vlorë. Kallaratasit, ashtu si 20 vjet më parë u mbledhën e krijuan shoqatën, që do të shërbente si një bashkim i mbarë kallaratasve, edhe sot pas 20 vjetësh u mbledhën përsëri në Vlorën e bukur, kujtuan këtë datë të veçantë, bën bilancin e punës, përcaktuan detyrat për vitin 2023. Nëpërmjet dhënies së disa certifikatave "Mirënjohje e Kallarati" vlerësuan disa nga figurat kryesore të shoqatës (ndarë nga jeta), plotësuan me anëtarë të rinj kryesinë e shoqatës dhe redaksinë e gazetës, për shkak të ndarjes së disave nga jeta, por edhe për një përfshirje më të drejtë të brezave dhe të vendbanimeve të kallaratasve brenda e jashtë vendit. Në fund kaluan një drekë mjaft të këndshme në restorantin e bashkëfshatarit tonë, Andon Leskaj të sponsorizuar prej tij.

Në fjalën e mbajtur në takim, kryetari i shoqatës z. Kastriot Karaboli përmendi veprimtaritë më kryesore të zhvilluara në këto 20 vjet si: Takimin e Brezave në Kallarati në vitet: 2005, 2007, 2009, 2011, 2104, 2016, 2021, 2022, e cila është veprimtaria më e ndjekur dhe që bashkon shumë bashkëfshatarë; përkujtimin e 70-vjetorit të rënies së Heroit të Popullit Mumin Selami 20 tetor 2012 në Kallarati në bashkëpunim me Organizatën e Veteranëve të rrethit; përkujtimin e 60-vjetorit të rënies të dëshmorit kallaratas, Ferik Strataj më 22 gusht 2009 me nismën e familjes Strataj dhe në bashkëpunim me shoqatën dhe Organizatën e Veteranëve të rrethit të Vlorës; bërjen e filmit dokumentar "Kallarati, realizuar në vitin 2005 nën kujdesin e ish kryetarit të shoqatës, të ndjerit, Gafur Shametit, dhe mbështetur financiarisht bashkëfshatarët kallaratas; dokumentarin televiziv "Kallarati, një Trojë e Vogël Labe", realizuar sipas esesë së intelektualit të njohur kallaratas, Petrit Qejvani me nismën e kryetarit të shoqatës, z. Kastriot Karaboli; sjelljen e eshtrave të patriotit Miftar Aliu nga Selcka e Gjirokastrës në vendlindjen e tij Kallarati; emërtimin e disa rrugëve të qytetit në Vlorë e në Tiranë me emra figurash të njohura nga Kallarati si: Mumin Selami, Duzë Bajrami, Myftar Kallarati; botimin që nga viti 2003 të gazetës "Kallarati" si përçuese të zërit të saj; organizimin në korrik të vitit 2014 veprimtarinë me rastin e 100-vjetorit të qëndresës trimërore kundër sulmit dhe

# 12 JANAR 2023

## NË VLORË U FESTUA 20 - VJETORI I KRJIMIT TË SHOQATËS "KALLARATI"

**“** *Kallaratasit, ashtu si 20 vjet më parë u mbledhën e krijuan shoqatën, që do të shërbente si një bashkim i mbarë kallaratasve, edhe sot pas 20 vjetësh u mbledhën përsëri në Vlorën e bukur, kujtuan këtë datë të veçantë, bën bilancin e punës, përcaktuan detyrat për vitin 2023.*

djegies së fshatit tonë nga andartët grekë më 1914; vendosjen e një pllakë përkujtimore në Koprifit për kryengritjen e Tanzimatit më 1847 me shënimin: "Kallarati, Kuç e Bolenë, në lumë ç'e zunë dyfeknë", realizuar nga gurgdhendësi duarartë Agim Mataj; festimin në gusht të vitit 2016 të 100 vjetorit e çeljes së shkollës së parë shqipe në Kallarati; zhvillimin e shumë veprimtarive përkujtimore

për dëshmorët e fshatit, por edhe për figura të tjera të shquara të Kallarati, të të gjitha kohërave; propmivim librash siç është "Historiku i Kallarati", shkruar nga Enver Strataj, apo pjesëmarrja në promovimin e dy librave me krijime të Petrit Qejvanajt; çeljen e uebsajtit [www.kallarati.com](http://www.kallarati.com) dhe të fejsbukut të shoqatës ku kallaratasit njihen të gjithë me ngjarjet dhe të rejtat në fshatin e tyre. Shoqata u ka bërë jehonë

ngjarjeve datave historike të fshatit, por edhe figurave të shquara të Kallarati, si në gazetë, ashtu edhe në rrjetet sociale. Në vijim në fjalën e tij Kastrioti theksoi "Jemi të ndërgjegjshëm se gjatë aktivitetit të shoqatës ka edhe detyra ende të porealizuara ku do të përmendim: Mosbërjen e përpjekjeve për realizimin e idesë së hedhur nga zoti Xhelo Dautaj në Kuvendin e vitit 2011, atë të mundësisë së shpalljes së Fshatit të Djegur "Fshat Muze"; mosngritjen e një grupi artistik të fshatit, ndonëse në mënyrë spontane, kemi një lëvizje në këtë drejtim të disa të rinjve; moskrijimin e një database, sipas degëve në rrethe me qëllim evidentimin e gjithë kallaratasve brenda e jashtë vendit, detyra këto që do përpiqemi t'i realizojmë në të ardhmen; moskryerjen si duhet të rolit të tyre disa prej degëve në rrethe, ashtu edhe jashtë vendit, të cilat në të ardhmen duhet të riorganizohen.



# DISA NGA VENDIMET E TAKIMIT

## 12 GUSHT 2023 - TAKIMI I BREZAVE NË KALLARAT.

Kryesia e shoqatës "Kallarati" në takimin e zhvilluar në Vlorë me rastin e 20 vjetorit të krijimit të shoqatës, në unanim të plotë edhe me gjithë pjesëmarrësit, vendosi: "Takimin e Brezave" për këtë vit ta zhvillojmë, ditën e shtunë në mbrëmje, më 12 gusht 2023 në Kallarati, kohë e mjaftueshme për të planifikuar lejet, në mënyrë të veçantë emigrantët të kallaratas anembanë botës.

## RINOVIMI I KRYESISË SË SHOQATËS "KALLARATI"

Për shkak të ndarjes nga jeta të disa anëtarëve të kryesisë së shoqatës si: Petrit Qejvani, ish sekretar i shoqatës; Seit Jonuzaj, ish anëtar i kryesisë së shoqatës dhe kryeredaktor i gazetës; Besnik Mataj, ish anëtar i kryesisë së shoqatës; Idajet Toçi, ish anëtar i kryesisë së shoqatës; Bejo Xhaferaj, ish anëtar i kryesisë së shoqatës dhe kryetar i degës së shoqatës "Kallarati" në fshat, si dhe për një përfaqësim më të mirë të komunitetit ku jetojnë kallaratas, përfshi edhe ata në emigrim, kryesia e shoqatës bëri zëvendësimet dhe plotësimet përkatëse deri në zgjedhjet e radhës, të cilat i bëri të njohura në Vlorë në datën 15 janar, në ditën e përkujtimit të 20 vjetorit të krijimit të shoqatës:

## RINOVIMI I REDAKSISË SË GAZETËS "KALLARATI".

Për shkak të ndarjes nga jeta të kryeredaktorit të gazetës "Kallarati" z. Seit Jonuzaj, i cili me shumë përkushtim dhe profesionalizëm e mbajti gazetën për shumë vite dhe të anëtarit të redaksisë, intelektualit, Petrit Qejvani, për t'i dhënë gazetës një frymë të re, si dhe për të patur një shtrirje më të mirë të anëtarëve të redaksisë, kryesia e shoqatës në mënyrë unanime vendosi të plotësohen vendet vakante, si dhe të shtohen anëtarë të rinj si më poshtë: Riza Memushaj, Itali, Fatmir Mataj, Vlorë, Eleni Memushaj, Kallarati, Selo Qejvani, Amerikë.

**Redaksia e Gazetës "Kallarati" të përbëhet:** Kryeredaktor i gazetës: z. Lefter Hysaj. Anëtarë: Hiqmet Meçaj e Fatmir Mataj (Vlorë), Çize Xhaferaj e Eleni Memushaj (Kallarati), Rami Memushaj e Besnik Gjonbrataj (Tiranë), Riza Memushaj (Itali) e Selo Qejvani (Amerikë). Arti grafik: Andi Meçaj

## NDEROHEN ME CERTIFIKATË "MIRËNJOHJE E KALLARATIT"

Shoqata atdhetare e kulturore "Kallarati", në ditën e festimit të 20 vjetorit të krijimit të saj, vlerësoi me certifikatë "Mirënjohje e Kallaratis" disa nga figurat kryesore (darë nga jeta) që kontribuan në vite për krijimin dhe funksionimin e shoqatës si më poshtë:

**Z. Gafur Shameti (Pas vdekjes)** "Për kontributin e dhënë për krijimin dhe drejtimin e shoqatës "Kallarati" dhe si kryeredaktor për disa vite rresht i gazetës së vendlindjes. Për meritën e veçantë në realizimin e filmit dokumentar "Kallarati". Për kontribute të çmuara si krijues, dhënë në fushën e artit e të humorit në estradën dhe teatrin e qytetit

të Vlorës e më gjerë dhe në jetën politike shqiptare, duke bërë krenar çdo bashkëfshatar kallaratas".

**Z. Bejo Xhaferaj (Pas vdekjes)** "Për përkushtimin dhe kontributin e dhënë ndaj vendlindjes e më gjerë në të gjitha detyrat shtetërore e shoqërore që ka kryer për një kohë të gjatë. Për kontributin e dhënë në funksionimin e shoqatës "Kallarati", e në veçanti në krijimin dhe drejtimin e degës së shoqatës në Kallarati, si dhe për ruajtjen dhe

propagandimin e vlerave patriotike e atdhetare të fshatit e të zonës së Labërisë"

**Z. Petrit Qejvani (Pas vdekjes)** "Për kontributin në krijimin dhe funksionimin e shoqatës "Kallarati" dhe kryerjen për disa vite rresht të detyrës së sekretarit të saj. Për kontributin e dhënë nëpërmjet shkrimeve për njohjen dhe propagandimin e vlerave patriotike dhe atdhetare të Kallaratis, në mënyrë të veçantë në realizimin e dokumentarit televiziv "Kallarati, një Trojë e Vogël Labe". Për

kontributet e dhëna si intelektual në jetën shoqërore të vendit, si edukator i brezit të ri, si drejtues institucionesh, si krijues e kritik ndaj dukurive negative të shoqërisë".

**Z. Razip Gollosaj (Pas vdekjes)** "Për kontributin e dhënë për krijimin dhe funksionimin e shoqatës "Kallarati" dhe kryerjen për disa vite rresht të detyrës së kryetarit të degës së Tiranës. Për kontributin e dhënë nëpërmjet shkrimeve për njohjen dhe propagandimin e vlerave patriotike dhe atdhetare të Kallaratis e të Labërisë, si dhe për kontributin e dhënë gjatë karrierës ushtarake për mbrojtjen e vendit".

**Z. Enver Gollosaj (Pas vdekjes)** "Për kontributin e dhënë për një kohë të gjatë në edukimin e brezit të ri kallaratas e në zonën e Vlorës. Për kontributin e dhënë për krijimin dhe funksionimin e shoqatës "Kallarati" dhe kryerjen për disa vite rresht të detyrës së sekretarit të saj. Për kontributin e dhënë nëpërmjet shkrimeve në gazetën "Kallarati" për njohjen dhe propagandimin e vlerave patriotike dhe atdhetare të Kallaratis e të Labërisë".

**Z. Enver Strataj (Pas vdekjes)** "Për kontributin e dhënë në krijimin dhe funksionimin e shoqatës "Kallarati". Për kontributin e dhënë nëpërmjet shkrimeve për njohjen dhe propagandimin e vlerave patriotike dhe atdhetare të Kallaratis e të Labërisë dhe në mënyrë të veçantë për botimin e librit "Historiku i Kallaratis", si një vlerë e çmuar për brezat e ardhshëm".



**KRYESIA E SHOQATËS KALLARATI PËRBËHET:** Luto Demiri, Lefter Qejvani e Violeta Xhaferaj (Kallarati); Kastriot Karabollaj, Llano Llanaj, Sefer Jonuzaj, Pëllumb Gjonbrataj, Selman Memushi, Lefter Hysi, Liri Shkurti, Alim Mehmetaj, Arjan Hoxhaj, Edmond Breshanaj, Ylli Breshanaj, Shkëlqim Leskaj, Agron Tozaj, Hasan Mehmeti e Afërdita Breshanaj (Vlorë); Edmond Strati (Fier); Gjergj Dautaj (Durrës); Gramoz Xhaferraj, Bako Xhaferaj, Arjanit Rjepaj, Besnik Strataj e Besnik Gjonbrataj (Tiranë); Agim Mataj (Itali); Lavdos Jonuzaj e Xhevdet Demiri (Greqi); Selo Qejvani (Amerikë); Andon Pango (Tiranë - Zagori).

**ORGANET DREJTUESE TË SHOQATËS:** Kryetar i Shoqatës z. Kastriot Karabollaj, nënkryetar i Shoqatës z. Besnik Gjonbrataj dhe sekretar i Shoqatës z. Hasan Mehmetaj.

## OBJEKTIVAT E SHOQATËS PËR VITIN 2023

Viti 2023, vit i cili shënon 20 – vjetorin e krijimit të shoqatës duhet të jetë një vit që duhet t'u japë një shtytje të re organizimit dhe planifikimit të veprimtarive të shoqatës. Përvoja mjaft e mirë

e krijuar në këto vite duhet të shërbejë si një bazë e mirë për përsosjen e punës së saj.

Parësore për këtë vit do të jenë: Zgjidhja e kryetarëve të degëve në disa rrethe ku mungojnë; zëvendësimi i anëtarëve të kryesisë së shoqatës ndarë nga jeta; zëvendësimi i kryeredaktorit dhe anëtarëve të redaksisë

së gazetës ndarë nga jeta; ringritja e degëve të shoqatës me kallaratasit në emigracion si në Greqi, Itali, por edhe në vende të tjera; përfundimi i historikut të fshatit; përkujtimi i ngjarjeve historike të

fshatit; përkujtimi i përvjetorëve të rënies së dëshmorëve; përkujtimi i figurave të shquara në periudha të ndryshme historike; zhvillimi i "Takimit të Brezave" për vitin 2023, ditën e shtunë, më 12 gusht në Kallarati; konsolidimi i ecurisë së gazetës, botimi, shpërndarja, etj; ringritja e grupit polifonik, etj.

**Kryesia e Shoqatës  
"Kallarati"**

*Parësore për këtë vit do të jenë: Zgjidhja e kryetarëve të degëve në disa rrethe ku mungojnë; zëvendësimi i anëtarëve të kryesisë së shoqatës ndarë nga jeta; zëvendësimi i kryeredaktorit dhe anëtarëve të redaksisë së gazetës ndarë nga jeta; ringritja e degëve të shoqatës me kallaratasit në emigracion si në Greqi, Itali, por edhe në vende të tjera; përfundimi i historikut të fshatit*

## INTERVISTA

INTERVISTOI:  
BESNIK GJONBRATAJ

# AFTËSITË PROFESIONALE DHE VLERAT E LARTA MORALE E QYTETARE E BËJNË MËSUESIN TË VLERËSUAR NË SHOQËRI

*Intervistë me mësuesin e përjetshëm të matematikës, kallaratasin, Hasan Mehmetaj*

Hasan Mehmetaj, lindur në Kallarat në vitin 1953 nga prindërit Boço e Venetike Mehmetaj, i rritur mes vuajtjesh dhe sakrificave si gjithë fëmijët e atij brezi, dashurinë e pasionin për dije do ta shfaqte që në vitet e para të fëmijërisë së tij. Hasani është një nga katër nxënësit kallaratas që bënë emër në gjimnazin e porsa hapur në Brataj në vitin 1969. I arsimuar për matematikë në fakultetin e Shkencave të Natyrës në Tiranë në vitet 1973-1977, ku ishte ajka e profesorëve më të dëgjuar të vendit, për rreth 17 vjet do të shërbente si mësues matematike në Vranisht, ku në vitin 1988 krijoi edhe familjen me vajzën nga Tërbaçi, Besien, pastaj në Llakatund, në Shkollën Industriale në Universitetin e Vlorës dhe në disa shkolla private. Aktualisht Hasani ka mbushur moshën e pensionit, por ai nuk i është ndarë mësimdhënies, ushtron përsëri profesionin e bukur të mësuesit të matematikës, por me kohë të pjesshme. Edhe pse dëshira e tij pas shkollës së mesme ishte për inxhinieri e mjekësi, sot ai shprehet se “Nuk do ta ndërroja me asnjë profesion a degë tjetër të mësuesisë”.

Një jetë të tërë, gati gjysmë shekulli si edukator e mësues i matematikës, për të nota ka qenë dhe është diçka e shenjtë. Ai asnjëherë nuk e ka përdorur notën si mjet presioni, por si stimul nxitës. Hasani me të drejtë konsiderohet nga opinioni si një nga mësuesit më të aftë profesionalisht të rrethit të Vlorës në lëndën e matematikës.

Duke folur për arsimin në ditët e sotme, Hasani tregohet kritik ndaj disa fenomeneve të kohës. “Mendimi im - shprehet ai - është që shkollat e mesme të jenë më shumë profesionale, të konsoliduara, të përqendruara, qoftë edhe me konvikt, ndërsa gjimnazit t’i jepet autoriteti që ka pasur dikur, si në staf pedagogjik, ashtu edhe në kërkesën ndaj nxënësve. Mësuesit duhet t’i jepet autoriteti i dikurshëm, si një personalitet i pazëvendësueshëm në selitjen e “fidanëve” të rinj për të lulëzuar “bahçen” e Atdheut.

Hasani është edhe një familjar i mirë e i rregullt. Për të familja është gjithçka. Bashkë me Besien, lindën, rritën, edukuan dhe arsimin dy çuna të mrekullueshëm, Kloudion arkitekt dhe Erionin inxhinier mekatronik, por ndarja e parakohshme nga jeta e bashkëshortes, shokut të jetës dhe nënës së fëmijëve Besiesë, ishte humbja dhe dhimbja më e madhe e krejt familjes. Megjithatë, jeta për ta vazhdoi dhe sot Hasani është bërë gjysh, por në memorie të tyre shfaqet vazhdimisht portreti i saj i veçantë, i bashkëshortes së denjë dhe i



nënës së mrekullueshme.

Hasani është një intelektual me vlera të larta profesionale e shoqërore. Ai është një tip që flet pak dhe kur duhet, duke i zënë vend fjala, por me gjuhën e numrave është “kampion” dhe si tillë nuk i pëlqen publiciteti. Për të mësuar më tepër rreth figurës së Hasanit si mësues i përjetshëm i matematikës, i kërkua realizimin e kësaj interviste. Le ta ndjekim profesor Hasanin nëpërmjet intervistës së mëposhtme.

## 1. Fëmijëria dhe shkollimi në vendlindje. Çfarë kujton sot në këtë moshë?

Në familjen e Boço e Venetike Mehmetaj

unë isha fëmija i tretë, pas Elmazit dhe Melaizes. Pas meje pasuan Labika, Havaja, Xhevdeti, Selvia. Kam lindur më 18 janar 1953, duke patur “asistente mami” gjyshe Shahidenë (nga babai). Në hapat e para të vetëdijes fëmijore sjell ndërmend kushtet e vështira ekonomike të familjes si gjithë shoqëria, pasojë e krizës që shkaktoi lufta e pushtuesve dhe varfëria e trashëguar.

Rugën e dijës e nisa në Morrez, ku ishte shkolla filllore. Mësues Servet Gollosi me durim e përkushtim na mësoi ABC-në dhe teorinë e numrave (Aritmetikën). Pasioni, dashuria për dije rriteshin bashkë me ëndrrat për të ardhmen, duke përballuar, jo pa

dhimbje, vështirësitë ekonomike, të veshur keq, në shi e breshër, ruanim çantën e librave e fletoreve, detyrat i kryenin nën dritën e llambës me vajgurit dhe kur mbaronte vajguri në dritën e zjarrit.

Shkollën 8 vjeçare e përfundova pothuajse me fletë lavdërimi, në dy pjesë: Klasën e V-VI e kreu në Bolenë (rreth tre orë larg), ndërsa klasën e VII - VIII në Kallarat. Kam dhënë provime në klasën e IV në Vranisht dhe klasën e VIII në Kallarat. Kujtoj me respekt mësuesit e pasionuar Lumturi Godaj (drejtoreshë), Bilal Breshani, mësuesi që na edukoi me bazat e Gjuhës Shqipe, xhaxhain tim Namik Mehmetaj, metodist e fjalëpakë dhe me një shkrim shumë të bukur, etj. Si komandant i çetës “Mumin Selami” kujtoj veprimtaritë jashtë shkollore si konkurse, lojërat sportive, ekskursione etj.

Dhe pas përfundimit të shkollës 8 vjeçare imagjinata shkonte përtej krahinës së Labërisë, që ngjan si një kështjellë natyrore, e rrethuar nga malet. Dëshira ishte që të gjeja shtigje, për t’i kapërcyer muret e kesaj “kështjelle” për dije, por një vit ëndrra mbeti në sirtar (!?)

## 2. Shkolla e mesme në Brataj, një prej katërshes së nxënësve kallaratas që bëri emër. Çfarë kujtimesh ruani sot?

Shtator 1969, në Brataj hapet i pari gjimnaz në krahinë. Lajmi u prit me gëzim të papërshtatshëm. Nga të gjitha fshatrat e krahinës; Kallarati, Kuçi, Bolena, Vranishti, Smokthina, Gjormi, Velça, etj vërshuan të rinj e të reja të





etur për dije. Dhe në krojet e gjimnazit të Bratit shuan etjen për dituri rreth 55 djem e vajza gjimnazistë (në vitet e tjera nxënësit vijuan degën bujqësore).

Grupi "3+1" (4 shokët nga Kallarati). Në vitin e parë të gjimnazit të përgjithshëm të sapo hapur, ishin dhe 3 kallarat: unë, Lefter Qejvani dhe Lefter Hysi, ndërsa në vitin pasardhës na bashkohet edhe Lavdosh Jonuzi, djal i zgjuar e këmbëngulës. Zjarri i dashurisë për dije, vullneti dhe vështirësitë e jetës familjare, ishin shtytësit kryesorë që në garën 4 vjeçare të shkollës së mesme, katërshja kallaratase, pa modesti, them që udhëhoqi jetën mësimore - edukative të shkollës. Në mësimet ishim të parët, po ashtu në jetën organizative. Unë isha sekretar i Komitetit të Rinisë, Lefter Qejvani, veçse aktivist rinie, ishte edhe "orquestra" e mbrëmjeve tematike -dëfrimi rinore, që janë antipod i "diskove" çoroditëse sot. Lefter Hysi si publicist e historian i ardhshëm, shkruante poezi dhe trajtonte tema nga historiku i fshatrave, gjithashtu së bashku kemi botuar edhe shkrime në gazetën "Zëri i Vlorës". Nga katërshja jonë, nuk mund të mos përkrahim me pak radhë shkollimin e shokut dhe mikut tonë L. Qejvani. Besoj se sakrificat e bërë prej tij do të jetë unikalë në brezin e atyre viteve! Ai vazhdoi shkollën për katër vjet vajtje ardhje Kallarati - Brataj në këmbë rreth 4 orë. Në diell e shi, në ngrica e acar, ishte shembulli i vullnetit, pasionit dhe sedrës për të qenë flamurtar. Ne tre të tjerët qëndronim edhe në konvikt. Në edukimin tonë ndikuan edhe mësuesit e përkushtuar dhe të komunikueshëm, metodistë të zot si B. Deromemaj, K. Mici, A. Ramaj, L. Hysi, L. Malaj, drejtori H. Abazi, B. Mici etj, për të cilët ruajmë kujtimet dhe respektin më të madh.

Pas përfundimit të gjimnazit rruga e dijes vazhdoi edhe më lart: L. Qejvani mbaroi Universitetin Bujqësor, dega Zooteknik, punoi në Veri, pastaj në Kooperativën bujqësore Bolenë - Kallarati dhe në vitet e tranzicionit në Komunën Horë - Vranisht. L. Hysi mbaroi Institutin e Gjirokastrës, dega Histori - Gjeografi, punoi edhe në Veri disa vite, më vonë mësues e drejtor shkollë në Bolenë e Kallarati e së fundi në Vlorë. Shoku tjetër i katërshes tonë, edhe pse një vit më pas, L. Jonuzi mbaroi Universitetin Bujqësor, dega Agronomi punoi në Veri dhe më vonë Kooperativën bujqësore Bolenë - Kallarati, ku me kompetencën dhe zotësinë e tij bëri që ekonomia të përparonte. Ndërsa unë ndoqa studimet e larta për Matematikë në Fakultetin e Shkencave, Tiranë.

### 3. Dega e matematikës, zgjedhja juaj, apo..?

E vërteta është që në tri kërkesat e paraqitura për studime, nuk kisha zgjedhur Matematikën. Këtë ma sugjeroi edhe mësuesi i respektuar A. Rama, duke më rekomanduar inxhinierinë dhe mjekësinë. Sikurse pas 8-vjeçares edhe pas gjimnazit "peripeçitë"

vazhdojnë. Komisioni i të drejtave të studimit në Komitetin Ekzekutiv, në fillim vendos për të shkuar në Mjekësi, por dikush propozon që unë të shkoja për Matematikë dhe një shoqja



jonë nga Bolena të shkonte për Mjekësi me arsyetimin se është femër e do kthehet të punojë në krahinë. E kundërta ndodhi, ajo nuk punoi asnjë ditë në fshatin e lindjes, ndërsa unë punova plot 17 vjet. (Ky konstatim është pjesë e dosjes time, jo episod rasti). Kështu që unë ndoqa studimet për Matematikë në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, degë të cilën vit pas viti ndoqa me vullnet e këmbëngulje, duke u diplomuar në vitin 1977. Edhe pse nuk u bëra dot mjek humanist, u bëra "mjek" për edukimin shkencor, mësues i Matematikës, profesion që nuk e ndërroj me asnjë lëndë tjetër.

### 4. Prej disa vitesh mësues i matematikës në Vranisht, ku krijove dhe familjen, diçka më tepër, për nxënësit dhe njerëzit në përgjithësi.

Kërshëria e parë në jetën profesionale ishte fillimi i punës në shkollën e bashkuar "Hysen Çino" në Vranisht më 15 gusht



1977. Sfidat ishin të shumta: integrimi në një kolektiv mësuesish të përgatitur, me eksperiencë dhe të përkushtuar në realizimin metodiko - shkencor të programit mësimor; tjetër ishte sfida e prezantimit për herë të parë me nxënësit, vështrimet e tyre, duke të bërë skanimin e karakterit, formimit dhe artin e komunikimit; gjithashtu pas këtyre qëndronin familjet, ku diferencat në kulturë dhe mentalitet kërkonin një përshtatje me kalim të rrjedhshëm sipas "avazit" të muzikës labe.

Gjatë zgjidhjes së disa problemeve pedagogjike me profesor Luan Hajdaragën dhe problemeve metodike me profesor Qazim Turdiu, në praktikat profesionale të zhvilluara në gjimnazin "Ismail Qemali" në Tiranë, kisha marrë komplimentet e tyre: "Ke për t'u bërë një mësues i mirë". Kjo sedër më ndiqte në çdo hap. Por tani vlerësimin do t'a merrja nga puna konkrete e "komisionit" të mëposhtëm: mësuesit - nxënësit - prindërit. Qysh ditët e para pata përkrahje morale nga ish drejtori F. Shkurti, nga ish mësuesit e gjimnazit B. Mici e G. Mëhilli, bashkëmoshatarët e mi M. Rrokaj e Sh. Aliaj, mësuesit L. Beqiri, L. Caraj, Sh.Pazo etj. Në klasa gjeta nxënës, shumica të përkushtuar, që bënë përpjekje për të përvetësuar kërkesat e programit. Natyrisht kishte edhe nxënës me prapambetje, që vinin nga familje jo me shumë kërkesa ndaj fëmijëve, duke patur mentalitetin "hë se në kooperativë do punojë".

Nga natyra jam i qetë, i durueshëm, por edhe kërkues për kryerjen e detyrave, shprehje të trashëguara nga mësuesit model të gjimnazit B. Deromemaj e A. Rama, etj. Dhe suksesi nuk vonoi. Tremujor pas tremujori, vit pas viti, ora e matematikës kalonte pa stresin e vështirësisë së vet lëndës, duke e pritur pa ankth "zilen e Matematikës", kur hyja në klasë.

Në trekëndëshin mësues - prindër - nxënës, secili komponent ka vlerën e vet. Me familjet e nxënësve ishim prezantuar gjatë punës pedagogjike në takime individuale e kolektive, gjatë veprimtarive kulturore - artistike në brigada (që ishin të shpeshta), kështu që ata e kishin krijuar opinionin e vetë për kërkesat e mia për mbarëvajtjen në matematikë të fëmijëve të tyre.



Përsa i përket nxënësve, në vitet '80 fshati i Vranishtit ishte një nga fshatrat më të mëdhenj në krahinë. Nevoja për arsim bëri, që veç shkollës së mesme ditën, të hapej edhe shkolla e mbrëmjes me të rinj arsimdashës jo vetëm nga Vranisht, por edhe nga fshatrat e tjerë si: Kallarati, Bolena, Tërbaçi, Mesaplikut e deri në Brataj.

Nëse në vitet '70 gjimnazi i Bratit ishte bërthama ku u përqendruan breza të rinjsh të motivuar për dije e kulturë, pa hezitim mendoj se në vitet '80 qendra e gravitetit të marrjes së dijes, u zhvendos në Shkollën e Bashkuar "Hysen Çino", Vranisht.

Ishte një staf pedagogjik për t'u pasur zili, si në kulturën e përgjithshme, ashtu edhe në atë profesionale. Gati çdo i ri dhe e re ndoqi shkollën e mesme. Dhe kjo solli një erë të re në kulturën familjare, në marrëdhëniet shoqërore e sidomos në prodim, ku parcelat eksperimentale u bënë laboratorit i prodhimit të gjerë në të ardhurat e kooperativës bujqësore. Përsa i përket listës së nxënësve, ajo është

shumemërore. Me nostalgji e respekt mund të përmend disa prej tyre: Sh. Shyti, Q. Azizi, J. Aliaj, Lumturi Shkurti, N. Hitaj, Lefteri Shkurti, T. Shkurti, N. Hallko (nga shkolla e ditës); Vojsava Hallko, Vangjel Bega, Ll. Breshani, F. Seraj, etj (nga shkolla e mbrëmjes). Nuk do të mjaftonin faqe të tëra për të pasqyruar jetën shkollërore të atyre viteve. Jo për nostalgji, por me dhimbje sjell ndërmend punën e palodhur të mësuesve, sakrificat e mëdha të nxënësve që vinin nga larg, por me dëshirë për të mësuar, e veçanërisht nxënësit e mbrëmjes me një zell e përkushtim të jashtëzakonshëm. Respektet e mia!

Sa për hedhjen e themeleve të familjes sime me Besien, do t'i përgjigjem në pyetjen e radhës. Ishim njohur si veprimtarë rinie, punuam në stafin pedagogjik si koleg, shokë të respektuar, deri sa rrahjet e zemrave arritën "rezonancën" e duhur. Gëtja shkruan: "Shumë rrallë në terezi, rri kandari i lumturisë, bëhu pra i shkathët ti në kohën e ardhmërisë....!" Dhe njëri do ta merrte iniciativën....

### 5. Mësues, ku tjetër? Po në Vlorë?

Nga Vranisht, pas shumë këmbënguljesh transferohem në Vlorë, në fillim në Llakatund, ku punova për rreth një vit e gjysmë, me një grup gjimnazistësh të mrekullueshëm, në maturë pata 16 vajza e 2 djem, të cilët dolën shumë mirë, dy prej tyre pas mbarimit të shkollës së lartë u bënë kolege e mia në Universitetin e Vlorës. Më vonë transferohen në shkollën Industriale, ku përsëri ruaj mbresa shumë të mira për opinionin e krijuar si mësues i aftë e metodist. Jo për mburrje, por më janë ofruar edhe poste për drejtor gjimnazi, si në gjimnazin e Vranishtit, zëvendës drejtor në Llakatund e shkollën Industriale, por që nuk i kam pranuar. Në vitin 1999 me kërkesën dhe mbështetjen e ish rektorit Bilal Shkurtaj, atashohem pranë Universitetit "Ismail Qemali" të Vlorës - niveli më i lartë i mësimdhënies si pedagog i Matematikës.

### 6. Ndonjë përjetim gjatë ushtrimit të detyrës si pedagog në universitetin e Vlorës?

Pranimi në universitet si pedagog i Matematikës, veç satisfaksionit për mësimdhënie në tempullin më të lartë të dijes, ishte edhe një obligim për të reflektuar në auditorë, në prani të studentëve, cilësitë e një pedagogu të aftë profesionalisht, të përkushtuar dhe metodist në artin e mësimdhënies. Vështirësitë e fillimit i kapërceva me punë këmbëngulëse dhe me ndihmën e pedagogëve E. Hasimja e A. Qilleri, paraardhës të mi nga Fakulteti i Shkencave, si edhe me kualifikimet në katedrën e matematikës, seminare e kualifikime në Tiranë e kualifikime njëmujore në Universitetin Politeknik, Trieste (Itali) dhe Athinë (Greqi). Gjatë viteve si pedagog m'u dha rasti të isha lektor dhe seminarist në degët Inxhinieri Navale e Navigacion, në Ekonomik, në Ciklin e Ulët dhe degën Matematikë - Fizikë, pra pak a shumë në çdo degë ku jepej Matematikë. Kudo, në çdo Fakultet ku dhashë mësim, studentët kërkonin të regjistroheshin me mua në leksione e seminare. Kjo më shtoi akoma më shumë sedrën profesionale, duke botuar edhe një tekst për Analizën Matematike për vitet e dyta Inxhinieri e Matematikë. Ndihej i lumtur që kontribuova në edukimin matematik të shumë brezave, një pjesë e tyre sot janë pedagogë të nderuar në Universitet, të tjerë punonjës në mjaft sektor të ndryshëm të jetës ekonomike e shoqërore.

### ... Ndonjë përjetim?

Duhej të përjetoja ngjarje jo të këndshme edhe në Universitetin e Vlorës. Ish rektor Shaskaj, i katapultuar nga Amerika në emër të "reformave" "shkriu" gjithë katedrën e

Matematikës në vitin 2009 me një e-mail nga përtej Paqësorit. Pse? Përgjigjen e mori nga Gjykata, ku të gjithë fituam anën financiare, por jo rikthimin (klauzolë e qeverisë Berisha!). Ndërsa vetë rektori, pasi na solli, si Abetaren e parë të Veqillharxhit, një tekst të përkthyer “Calculus”, që e futi në çdo degë me çmimin 100 dollarë, iku nga kishte ardhur, duke mos ia hequr dot Universitetit të Vlorës, emrin “Ismail Qemali”. Pas viteve të punës në universitet, vazhdoj të jap mësim në Gjimnazin nr.1, Vlorë.

### 7. Nota për ju, diçka e shenjtë, a keni abuzuar ndonjëherë me të?

Nota është “metri” për të kryer vlerësimin e njohurive të nxënësit për një ose disa çështje mësimore, ballafaquar me kompetencat



teorike dhe shprehite praktike. Matematika, si shkencë ekzakte, ku konceptet lidhen organikisht me njëri tjetrin, është më e evidente për të matur nivelin e përvetësimit dhe shkallën e vështirësive. Një mësues që zotëron mirë lëndën dhe ka artin e transmetimit të njohurive, është në gjendje të bëjë vlerësime reale, larg simpative, dallimeve dhe subjektivizmit. Në këtë aspekt, kurdoherë jam udhëhequr nga parimi pedagogjik: “Koka e nxënësit nuk duhet konsideruar si një thes që duhet mbushur, por si një kopsht i lulëzuar, që duhet selitur çdo orë mësimi”. Nota nuk ka vetëm vlerë sasiore (1, 2...10), por edhe vlera emocionale, nxitëse e ballafaquar. Asnjëherë notën nuk e kam përdorur si presion, por kurdoherë si mjet matës për nivelin e njohurive dhe stimul nxitës. Vlerësimin e kam kryer, jo vetëm me ndonjë një ushtrim (në klasë apo detyrë shtëpie) apo me një perifraxim teoreme, por me shumë testime. Në klasë nuk kam dashur të di se i kujt është nxënësi nga familje kuadri, me “pikë” në biografi apo edhe i afërmi im. Arsyetimi i përgjigjeve, transparencë në vlerësimin me notë dhe ballafaqimi me gjithsecilin, mbeten kërkesa kryesore në çështjet e vlerësimit të nxënësit. (Një mësues i aftë nuk i vendos notat në sallën e mësuesve, apo diku tjetër.)

Nga gjithë përvoja 45 vjeçare nuk kap patur reklamim për vlerësimin, përkundrazi jam ndier i respektuar nga nxënësit, prindërit dhe opinioni i gjerë. Në provimet e zakonshme të kryera nga inspektimi, apo maturat shtetërore, shkalla e “gabimit” ka qenë shumë e vogël. Rezultatet e maturantëve të mi, kurdoherë kanë qenë ekselente. Gjimnazi Nr.1 na pasur rezultate të Maturës, ndër vendet e para, jo vetëm në Qarkun e Vlorës.

### 8. Gjatë ushtrimit të mësimdhënies të lëndës së matematikës, nga opinioni konsiderohesh mësues i “vështirë”, por shumë i drejtë, korrekt dhe i zoti. Ndonjë koment për këtë konstatim?

Vlerësimi ka dy anë, anën e jashtme dhe të brendshme, pra opinionin dhe vetëvlerësimin. Parimi im në jetën intelektuale ka qenë kompetenca në zotërimin e lëndës, arti i transmetimit tek auditori dhe transparencë në vlerësime. “Vështirësia” si mësues ka qenë dhe mbetet mospajtueshmëria me diferencat, apo preferencat në vlerësime (jo në mësimdhënie). Nuk kam dashur të di që në klasë ka fëmijë të “vipave”, të drejtorëve

apo zyrtarëve, të fshatit apo qytetit, qofshin edhe të afërm. Të gjithë për mua kanë qenë njëlloj, të barabartë. Ndoshta muajt e parë qëndron nofka “i vështirë”, por në vitet e fundit komunikimi dhe mirënjohja ka qenë e madhe. Në klasën e shtatë, për hir të shkrimit të bukur, shkrova në një fletë kartoni parullën: “Shoku mësues, më ndihmo, më kontrollo, por mos më bëj lëshime”. Flitet para viteve ‘70, në kuadër të revolucionarizimit të shkollës, kur unë nuk e kisha shkuar ndërmend se kjo parullë, shumë më vonë do bëhej lajtmotivi i jetës sime profesionale. Një mësues i mirë, me punë këmbëngulëse, me durim dhe stimulim arrin “të shkrijë” akullin midis lëndës së vështirë dhe formimit gradual të koncepteve (gota e ujit nuk pihet menjëherë). Shpesh nxënësve i them se Matematika është më e thjeshtë se lëndët e tjera, nëse ndjek hap pas hapi hallkat kryesore, kryen me punë të pavarur detyrat e dhëna dhe krijon besim të lënda. Me Matematikën nuk bie në dashuri “me shikim” të parë, por pas një pune sistematike e këmbëngulëse.

9. Nga nxënësit që ke kaluar, të cilët janë të shumtë, a mund të veçosh ndonjërin prej tyre që ka qenë talent në matematikë?

Është e vërtetë, për gati 45 vjet është një plejadë e tërë nxënësish e studentësh që në formimin matematik kanë spikatur me përkushtimin dhe këmbënguljen për të qenë elitë në klasat përkatëse. Do të më pëlqente të evidentoj disa nga nxënësit e parë të viteve ‘80, kjo për arsye se, përveçse më dhanë kënaqësinë e profesionit tim, por në kushte jo komode (krahasuar me ditët e sotme) u bënë promotor të zhvillimeve arsimore (qofshin ditën, qofshin edhe në mbrëmje). Nxënësit Shqiponja Shyti, Qerime Azizi, Nasipe Hitaj, Leteri Shkurti, etj nga nxënësit e ditës, si edhe Vangjel Begaj (Asllani), Vojsava Hallko e Llukan Breshani, etj nga shkolla e mbrëmjes, me përgatitjen e tyre i bënin nder vetes e familjeve të tyre, shkollës ku formuan me arsimin e mesëm dhe një motiv më tepër në punën tonë të përditshme. Shumica e nxënësve, si të Ditës edhe të Mbrëmjes, ndoqën arsimin e lartë, duke punuar në sektorë të ndryshëm të ekonomisë, si arsim, shëndetësi, ushtri, agronomi, veterineri, etj.

### 10. Sa kanë ndikuar në formimin tuaj mësuesit e pedagogët e tu të matematikës dhe çfarë mendon se ke marrë prej tyre? A mund të kujtosh disa prej tyre?



Drejtimi profesional që njeriu merr në jetë kushtëzohet si nga përkushtimi, dashuria për profesionin, aftësimi i vazhdueshëm dhe modeli që të udhëheq.

Deri në gjimnaz mësuesit i kam pasur model për punën e tyre plot pasion, trajtimin metodik, punën me shkrim dhe komunikimin shkencor e shoqëror. Kështu në klasën e V-VI të tetëvjeçares, mësuesi i vizatimit, Muharrem Leskaj ndikoi te unë mjaft në shkrimin e bukur, ishte i veçantë si në vizatime të lira, ashtu



edhe në të shkruarit, që u bë pjesë e edukatës time në punët me shkrim. Gjithashtu xhaxhai, Namiku kur jepte mësim karakterizohej nga qetësia dhe dallohej për shkrimin e dorës shumë të bukur. Po ashtu mësues Bilal Breshanaj na edukoi plot pasion e kërkesa rregullat drejtshkrimore të Gjuhës Shqipe, që qysh nga tetëvjeçarja formimin gjuhësor ia dedikoi atij mësuesi.

Seriozitetin, saktësinë dhe metodikën e mësimdhënies i përvetësova nga mësuesit e shkencave të gjimnazit: Besnik Deromemaj, Kujtim Mici e Adriatik Ramaj, si dhe drejtori Halo Abazi - mësues që i pata si model në karrierën time. Në universitet mund të pohoj se Shkencat e Natyrës patën pedagogë me emër, të kualifikuar jashtë vendit si: Petraq Piliqa, Aleko Minga, Skënder Gjinushi, Rexhep Meidani, Osman Kraja, Makbule Çeço, Qazim Turdiu, Luan Hajdaraga, Ç.Teliti etj. Ishim me fat që brezi ynë u diplomua nga këta korifej të shkencës, të zotë në mësimdhënie dhe shumë njerëzor në marrëdhëniet pedagog - student, metodistë të zotë. Këta ndikuan edhe në formimin tim profesional, duke pasur në çdo hap si udhëheqës metodistë model të një mësimdhënësi.

### 11. Me daljen në pension, cili është angazhimi Juaj në jetën shoqërore e intelektuale?

Jeta i nënshtrohet ligjeve të natyrës dhe atyre shoqërore. Sipas tyre jeta e njeriut kalon në tre stadi: rinia - jeta aktive - moshë e tretë (pensioni). Ndoshta

kalimi i viteve në moshën e tretë, s’na pëlqen, por rrjedhjen e kohës, as e ndalojmë, as e kthejmë dot pas. Kjo është dialektika. Me daljen në pension, unë nuk e ndërpreva veprimtarinë profesionale, duke vazhduar mësimdhënien me kohë të pjesshme në gjimnaz. Përvoja jetësore, edukata profesionale dhe aktiviteti fizik e mendor, veç vlerave personale, kanë edhe vlera shoqërore, pasi eksperiencia dhe performanca e mirë janë vlera për shoqërinë, aq më tepër kur merresh me edukimin e rinisë.

Ndjem krenar, që si mësues i Matematikës jam vlerësuar edhe me certifikata mirënjohje nga Ministria e Arsimit, Drejtoria Arsimore dhe Këshilli Bashkiak. Veç anës profesionale, në takime me të rinj e shokë diskutojmë edhe për edukimin e fëmijëve tanë e brezave të rinj me dashurinë për vendlindjen, për promovimin e vlerave historike e jetësore, duke restauruar shtëpitë dhe transmetuar vlerat kulturore, që i mungojnë shumë komunitetit. Në këtë aspekt brengë mbetet një “rilindje” e jetës në fshatin tonë Ndoshta të rinjtë do ta kthejnë kokën nga “Troja e Vogël – e Kallararit”, për ta zhvilluar, sipas mundësive dhe kushteve të reja.

### 12. Përjetuat humbjen e parakohshme të bashkëshortes Besies, njeriut të jetës, e cila përveç kontributit ndaj familjes, kishte një kontribut të vlerësuar shoqëror, ç’mund të kujtoni dhe thoni për të?

Jeta shoqërore ka në themel familjen, si bërthamë në të gjitha sistemet shoqërore. Kam mendimin se njeriu në jetë ka dy sfida kryesore, krijimin e një familje harmonike dhe integrimin në jetën shoqërore aktive. Ndërsa këtë të dytën e kisha zgjidhur në më të mirën e mundshme, sipas kushteve të kohës, për të parën vendosmëria nuk bazohej as në dhënie provimesh e as pjesëmarrje në panairë. I përkas tipit të flegmatik të personalitetit, i prirur për të kontrolluar emocionet, këmbëngulës në realizimin e një detyrë të ngarkuar, pak indiferent dhe i përmbajtur në marrjen e vendimeve të mëdha në jetë.

Me Besien isha njohur qysh në rini, kur ishim në aktivitete të rinisë, duke zhvilluar seminare e veprimtari të përbashkëta me Komitetin e Rinisë. Pas përfundimit të Universitetit, unë u ktheva në Vranisht ku gjeta në kolektiv edhe Besien në fillim mësuese e më vonë si drejtuese e Byrosë së Partisë të kooperativës dhe më pas përsëri punuam në një kolektiv, tani të dy mësues në shkollën e mesme. Pas një periudhë jo të vogël njohje, tik - taku i zemrave tona arriti “rezonancën” e nevojshme, deri sa në tetor 1988 krijuam familjen. Si familjarë kompensonim njëri tjetrin, ajo e socializuar dhe shumë e drejtpërdrejtë në gjykime, unë korrekt dhe këmbëngulës në anën profesionale. Me sakrificë jeta e re nisi në shtëpinë e re në Kallarar. Në vitet e para shkonim e ktheheshim nga puna në Vranisht, reth tre orë larg, në kohë të mirë e të keqe, por asnjë ditë nuk mungonin nga puna.

Lindja e dy fëmijëve ishte lumturia e familjes së re për gjyshen e të afërmit (dajo, xhaxhallarët, teze e halla). Pas transferimit në Vlorë familja jonë ishte shndërruar në një



kthym në forcë, çunat vunë në jetë amanetet e nënës, për ne mbetet bashkëshorte model, nënë e përkushtuar, mësuese e devotshme, aktiviste e dalluar shoqërore. Për këtë kam patur vlerësime pune nga Drejtoria Arsimore, Këshilli Bashkiak e Shoqata Atdhetare e Kulturore "Tërbaçi". Koha për Besien ndaloj, por për ne rrjedha e kohës vazhdon, duke patur gjithmonë pranë dashurinë familjare e shoqërore.

### 13. Keni dy fëmijë të mrekullueshëm, cila ka qenë zgjidhja e tyre në shkollë e jetë?

E vërtetë që një familje ndihet e lumtur, kur në jetë sjell trashëgiminë, lufton me kërkesat e përditshme dhe përjeton të ardhmen. Duke qenë se nga kontributi ynë kanë dalë breza djemsh e vajzash të mrekullueshme, s'kishte si të ndodhte ndryshe për mirëedukimin e çunave tanë. Ndërsa nëna qëndronte më afër

problemeve humanitare e edukative, babai kishte kujdesin e formimit shkencor për të ardhmen. Dhe përpjekjet tona nuk na zhgënjyen. Pas përfundimit të gjimnazit (ishin



një vit diferencë në moshë), Klaudioja aplikon disa degë dhe "godet" në profesionin e babait, i del e drejta e studimit në Fakultetin e Shkencave për Matematikë. Pasi vazhdoi mbi tre javë në këtë degë, ndryshuam mendim si

familje dhe regjistrohet në Arkitekturë, degë të cilën e përfundoi shumë mirë, duke e dashuruar profesionin. Punon në Urbanistikën e Vlorës, duke pasur firmën e vet në disa vepra si: Ura e Zvërnecit, lokale e pallate në Lungomare, në veprën Lungomare 2. Bashkë me projektet profesionale ka projektuar edhe jetën familjare, duke qenë vazhdues i kërkesave për një jetë serioze e dinjitoze

Ndërsa Erioni përfundoi Inxhinierinë Mekatronike dhe sot punon në një firmë gjermane në Tiranë, ka kryer një sërë kualifikimesh jashtë vendit dhe ndihet mjaft mirë profesionalisht. Erioni ka avancuar në lidhje me vëllain, pasi ka krijuar familje me shoqen e jetës Dianën (juriste), duke sjellë në jetë gëzimin e familjes, Nolanin e vogël, i cili më dha statusin "gjysh". Si prind jam krenar, që sakrificat tona i justifikuan duke dalë në jetë. Shpesh më duhet të bëj "korrigjimet" e detyrave që kryejnë (por jo me laps të kuq).

### 14. Çfarë do t'iu sugjeronit sot fëmijëve në shkollë, jo vetëm për matematikën, por në përgjithësi për mësimin?

Çdo bazë ekonomike kërkon edhe superstrukturën e vet, njerëzit intelektual e profesionistë. Ndërsa brezi ynë u rrit në një sistem ku edukimi ishte i centralizuar, përgatitja profesionale e kishte të sigurtë vendin e punës, sot zhvillimet drejtohen nga diversiteti i lartë i zhvillimit ekonomik e social. Nëse brezi ynë edhe pse punoi në dy sisteme të ndryshme ekonomiko -shoqërore, kishte formimin profesional, përkushtimin ndaj punës e familjes dhe arriti të integrohej me kërkesat

arsimim, kualifikim e synim, gjithmonë e më shumë se gjithçka realizohet.

15. Çfarë mendon si të veçantë që trashëgove në jetë nga prindërit dhe çfarë u përcjell ti sot fëmijëve të tu?

Familja jonë ishte e madhe: dy prindër dhe shtatë fëmijë. Deri në vitet '70 nuk bëhej fjalë për mirëqenie, por për mbijetesë. Si shumica e brezit të tyre, prindërit e mi nuk kishin kulturë arsimore, por kishin kulturën dhe shkollën e jetës. Me sedër, korrekt dhe të përkushtuar në punët e kooperativës na rritën dhe edukuan me dashurinë për familjen dhe punën, larg veseve të këqija. Me të ardhurat e siguruara,



u përpoqën që unë, Xhevdeti e Selvija, të përfundonim shkollën e mesme, përkatësisht gjimnazin, bujqësoren dhe ekonomiken. Ndërsa të gjashtë fëmijët u bënë krah pune, unë ndoqa studimet e larta. Prindërit tanë ishin kërkues ndaj fëmijëve për punë të ndershme, sjellje korrekte dhe qëndrim të drejtë në marrëdhëniet shoqërore. Ky është kapitali që trashëguam prej tyre. Ne si fëmijë nuk u bëjmë "gjyqin" pse nuk na lanë prona e pasuri, pasi e tillë ishte gjendja ekonomike e shoqërore e jetës në ato vite kudo në fshatra.

Sot, që unë vet jam prind, edhe pse rritur e edukuar në vitet e tranzicionit, kërkesat për çunat e mi janë arsimimi, kualifikimi i vazhdueshëm, ndërtimi i një familje harmonike dhe prezantimi si "dikush" në jetë.

### 16. Diçka për vendlindjen, Kallaratin, jo vetëm për banorët që jetojnë atje, por për gjithë kallaratasit, tashmë anembanë botës, çfarë mesazhi keni për ta?

"Guri i rëndë peshon në vendin e vet" - thotë populli. Prandaj vendlindja është një "gur" sinori për gjendjen civile të secilit. Fëmijërinë dhe rininë e kalova në fshat, ku luaja me shokët, bëmim "plazh" në lumë, krevat shkollën 8 - vjeçare, punova edhe në brigadë bujqësore, në ndihmë të familjes. Zhvillimet e viteve '80 në Kallarati i kujtoj me nostalgji me moshatarët e mi, duke ua treguar edhe çunave, një jetë e vështirë, por edhe e bukur.

Fshati pati shkollë model, qendër kulturore, bibliotekë, muze historik, qendër shëndetësore me mjekë, infermierë e mami, fushë sportive, etj. Tranzicioni solli ndryshime drastike në fshat, të gjitha ato qendra të arsimit, shëndetësisë e kulturës i "zhdukën", fshati u boshatis, aq sa sot ka pak banorë, pothuajse të moshës së tretë.

Kallaratasit kanë qenë punëtorë, arsimdashës dhe patriotë. Breza të shumtë kuadro kanë shërbyer e shërbejnë në sektorë të ë ndryshëm. Djemtë e vajzat që emigruan jashtë vendit, kanë ndërtuar një jetë më të mirë. Vitet e fundit vihet re kthimi i "vështirimit" nga vendlindja, nga shtëpitë e prindërve, të cilat po i restaurojnë. Shpresoj që brezat e rinj do t'ia kthejnë dinjitetin e dikurshëm fshatit Kallarati, për të mos thënë "na ishte dikur", sikurse themi për "Fshatin e Djegur" në prehrin e Bogonicës.

**Faleminderit për intervistën**



NGA BESNIK GJONBRATAJ

## SHOQATA “KALLARATI”

FESTOI NË TIRANË 80 -  
VJETORIN E GJUHËTARIT  
TË NJOHUR, PROFESOR  
RAMI MEMUSHAJ

Në një atmosferë tepër festive, shoqërore e familjare, shoqata “Kallarati”, dega Tiranë, në kuadrin edhe të 7 marsit, “Ditës së Mësuesit”, në lokalin “Zagoria” të z. Andon Pango, (tashmë edhe anëtar i kryesisë së shoqatës “Kallarati”), zhvilloi në Tiranë një aktivitet shumë kuptimplotë, kushtuar 80 - vjetorit të lindjes, së njërit prej gjuhëtarëve më të dëgjuar të vendit, njërit prej atyre që ka kontribuar dhe vijon të kontribuojë në njohjen, zhvillimin dhe mbrojtjen e gjuhës standarde shqipe me studime, kumtesa, ligjërata, botime shkencore të shumta, birit të Kallarait, profesor Rami Memushaj.

Në këtë aktivitet përveç pjesëtarëve të familjes, bashkëfshatarëve të shumtë kallarratas me banim në Tiranë, morën pjesë edhe kryeredaktori i gazetës “Labëria”, gazetari dhe shkrimtari i njohur z. Albert Zholi, kryetari i shoqatës “Kallarati” me qendër në Vlorë z. Kastriot Karaballi, kryeredaktori i gazetës “Kallarati”, z. Lefter Hysi, gazetari Pano Hallko, pjesëtar të grupit lab, etj.

Takimi ishte përparësi si një surprizë për profesorin nga një grup kallarratas me banim në Tiranë pasi nga natyra e tij profesor Ramiu i përkushtohet punës e studimeve dhe është larg festimeve të tilla, por profesori e meritonte një kujtesë të tillë në këtë 80 - vjetor, në një kohë që vetë institucionet shtetërore, Fakulteti i Gjuhës Shqipe, ku shërbeu mbi 35 vjet si pedagog, Instituti i Studimeve të Gjuhës Shqipe, nuk kujtohen për të nderuar figura të tilla, qoftë edhe me një mirënjohje. Por vendlindja, miqtë e shokët e tij nuk e harrojnë profesorin për gjithçka që ai ka bërë për gjuhën shqipe, Kallaratin, Labërinë dhe mbarë Shqipërinë. Një buqetë me lule, sapo profesor Ramiu hyri në lokal, vllente shumë për të.

Fjalën e rastit e mbajti një nga nismëtarët e këtij takimi z. Besnik Gjonbrataj, i cili pasi falënderoi të gjithë pjesëmarrësit, duke folur për aktivitetin dhe kontributin e profesor Ramiut në fjalën e tij mes të tjerash theksoi:

“Të dashur pjesëmarrës! Mirë se erdhët në këtë event shumë të veçantë të festimit të 80 - vjetorit të lindjes së njërit prej kallarratasve me kontribute më të mëdha në arsimin shqiptar dhe jo vetëm, Profesor Rami Memushaj. Profesori, edhe pse njihet nga të gjithë, jo vetëm në Shqipëri, por edhe në trevat shqipfolëse, si një intelektual dhe akademik i shquar i fushës së gjuhësisë, në respekt të kontributit të tij, intelektual e shoqëror më takon të them dy fjalë.

Profesor Ramiu lindi në Kallarat të Vlorës në një familje patriotike në kohën kur vendi ishte i pushtuar, u rrit si gjithë fëmijët e atyre viteve mes vështirësive, por me dëshirën e zellin për të studiuar, deri sa përfundoi shkollën e mesme pedagogjike në Vlorë dhe të lartën për Gjuhë - Letërsi në Tiranë.

Profesor Ramiu ka një jetë të tërë, si edukator, mësues e pedagog i brezit të ri, duke nisur nga Gjormi, Bolena, Vajza, Vranishti e Llakatundi të rrethit të Vlorës, e duke vazhduar për shumë vite, që nga 1974 e deri në vitin 2011, kohë kur doli në pension, mbi 35 vjet pedagog i Gjuhës Shqipe në Universitetin e Tiranës.



Breza të tërë nxënësish dhe studentësh anembanë vendit, kanë njohur kontributin e profesor Ramiut në arsimimin dhe formimin e tyre profesional dhe intelektual.

Përveçse pedagog në Tiranë, profesor Ramiu ka shërbyer 5 vjet si lektor i gjuhës shqipe jashtë vendit: dy vjet pranë katedrës së gjuhës shqipe të Universitetit të Gjuhëve të Huaja të Pekinit dhe 3 vjet pranë katedrës së gjuhës shqipe të Universitetit të Palermos.

Pas viteve 90-të profesor Ramiu ka kryer disa specializime disa mujore jashtë vendit për kërkime shkencore pranë Universitetit të Berlinit, në Kaliforni; pranë Universitetit Danimarkës; pranë Universitetit të Bremenit Gjermani. Është njohës i disa gjuhëve të huaja: rusishtes, anglishtes, italishtes,

rumanishtes e frëngjishtes.

Profesor Ramiu ka kryer detyrën e përgjegjës të departamentit të gjuhës shqipe (1993–1997), përgjegjës seksioni pranë këtij departamenti (2001–2011); anëtar redaksie i revistave shkencore “Gjuha jonë” (1995–1998), “Studime albanologjike” (1996–2004) dhe “Studime filologjike” (2001 e deri sot). Ka botuar një varg librash, monografish, përmbledhje artikujsh dhe tekste mësimore universitare e të shkollës së mesme: Monografi: Morfologji e eptimit të gjuhës së sotme shqipe (1989, ribotim 2008), Gjuhësia gjenerative (2003, ribotim i përmirësuar 2008), Himara në dritën e të dhënave historike, gjuhësore dhe etnologjike (2004), Histori e Kurveleshit, I (2004); Gjuha

shqipe në shtratin e Prokrustit (2013); tekste universitare: Hyrje në gjuhësi (1986 e ribotim 1990, bashkautor), Shqipja standarde (2002), Hyrje në gjuhësi (2002), Fonetika e shqipes standarde (2009); tekste për shkollën e mesme: Teste gjuhësore (2003, me bashkautorësi), Gjuha shqipe 1 (Podgoricë, 2007), Gjuha shqipe 2 (Podgoricë, 2008), Gjuha shqipe 3 (Podgoricë, 2009); përmbledhje artikujsh: Për shqipen standarde 1 (2013), Për shqipen standarde 2 (2013), Për shqipen standarde 3 (2017), Për shqipen standarde 4 (2022), Studime gramatikore (2017); fjalorë: Fjalor drejtshkrimor i gjuhës shqipe (2011, 2015, bashkautor). Kam mbajtur leksione në disa universitete evropiane (Bukuresht, 1992; Arhus e Roskilde – Danimarkë, 1993; Bremen, 1995; Mynih, 2007) dhe amerikane (Chapel Hill – Karolina e Veriut, 1993; Berkli – Kaliforni, 1993).

Ka kumtuar në konferenca shkencore të organizuara nga universitete evropiane (Jashi – Moldavi, Patra – Greqi, Kozencë, Palermo, Sofje, Osnabryk e Mynih) si dhe nga të gjitha universitetet shqiptare në Shqipëri, Kosovë e Maqedoni e Veriut. Ka botuar dhjetëra e dhjetëra punime e artikuj në revista shkencore të huaja dhe shqiptare të Shqipërisë, Kosovës dhe të Maqedonisë së Veriut. Vazhdon të punojë e të botojë.

Profesor Ramiu i është kushtuar për vite të tërë studimeve në fushën e gjuhësisë, duke fituar shkallë - shkallë gradat shkencore dhe në vitin 2004 ka fituar gradën më të lartë shkencore, “Profesor doktor”. Gradën “kandidat i shkencave” e ka fituar në vitin 1985, Gradën “doktor i shkencave” më 1992, titullin “profesor i asociuar” më 1995 dhe “profesor doktor” më 2004. Ka fituar disa bursa specializimi: bursën 8-mujore Fullbrajt për kërkime shkencore pranë Universitetit të Berlinit, Kaliforni (shtator 1992 – maj 1993; bursën 3-mujore TNRS (qershor 1993 – shtator 1993) pranë Universitetit të Roskildes (Danimarkë); dhe bursën njëmuajore “Tempus” (nëntor 1995) pranë Universitetit të Bremenit (Gjermani). Ka qenë i ftuar nga Universiteti i Bukureshtit në kurset e verës të gjuhës dhe të kulturës rumune (Sinaia, korrik 1992).

Ka botuar një varg librash, monografish, përmbledhje artikujsh dhe tekste mësimore universitare e të shkollës së mesme, studime të ndryshme gjuhësore. Është autor i





katër volumeve "Për shqipen standarde", autor edhe i librave të gjuhës shqipe për Podgoricën, bashkautor fjalori drejtshkrimor të gjuhës shqipe, etj. Ka mbajtur leksione në disa universitete evropiane si në Rumani, Danimarkë, Gjermani, por edhe në Amerikë. Ka kumtuar në konferenca shkencore të organizuara nga universitete evropiane si në Moldavi, Greqi, Itali, Bullgari, Gjermani, si dhe në të gjitha universitetet shqiptare në Shqipëri, Kosovë e Maqedoni e Veriut. Ka botuar dhjetëra e dhjetëra punime e artikuj në revista shkencore të huaja dhe shqiptare të Shqipërisë, Kosovës dhe të Maqedonisë së Veriut dhe vazhdon të punojë e të botojë akoma.

Që prej vitit 1995 e këndej ka qenë tepër aktiv në debatet për gjuhën letrare, duke qenë një ndër mbrojtësit e saj dhe ndër kundërshtarët e projektit të disa qarqeve akademike për të ndryshuar drejtshkrimin e shqipes. Kësaj tematike i ka kushtuar katër përmbledhjet "Për shqipen standarde" dhe librin "Gjuha shqipe në shtratin e Prokrustit", në të cilin merret në analizë projekti i drejtshkrimit i Këshillit Ndërkademi për Gjuhën Shqipe dhe argumentohet rreziku që i kërcënohet shqipes letrare nga zbatimi i këtij projekti. Për këtë problematikë ka dhënë edhe shumë intervista në gazeta, televizione e radio të të tria këtyre shteteve, duke kontribuar në bllokimin e këtij projekti.

Midis kontributit të tij shkencor e shoqëror do të veçonim edhe atë për vendlindjen, Kallaratin, shoqatën dhe gazetën me të njëjtin

emër. Profetori është i pranishëm në Kallarati në çdo veprimtari, në çdo përkujtim ngjarjesh e datash historike me fjalime, por edhe me mendime e ide konkrete për t'a zhvilluar më tej Kallaratin, për të rritur dashurinë e brezit të ri ndaj vendlindjes.

Gjithashtu një kontribut të rëndësishëm ka dhënë edhe për krahinën e Kurveleshit dhe të mbarë Labërisë me botimin e dy librave (Historia e Kurveleshit dhe Himara), për të cilën Shoqata e Labërisë i ka dhënë edhe titullin "Personalitet i Shquar i Labërisë".

Profesor Ramiu, përveçse një personalitet i shquar i shkencës, e në mënyrë të veçantë i gjuhësisë, është prind shembullor i tre çunave dhe një bashkëshort i denjë, ku në suksesin e tij, meritë të veçantë ka Adriana, bashkëshortja e tij, e cila falë edhe profesionit të saj si mësuese, ka qenë gjithmonë dhe vazhdon të mbetet, jo vetëm mbështetësia kryesore për ta lehtësuar atë nga detyrimet familjare, por ka luajtur rolin edhe të redaktore apo të kritikës në krijimtarinë e tij. Kot nuk i thonë se "Pas një burri të suksesshëm qëndron një grua e fortë". E tillë është edhe Adriana.

Edhe pse në këtë moshë profesor Ramiu vazhdon të jetë tepër aktiv në jetën shoqërore të vendit dhe në atë të shoqatës Kallarati. I pranishëm vazhdimisht në media dhe me plane për botime të tjera në fushën e gjuhësisë.

Duke përfunduar në emër të gjithë pjesëmarrësve i urojmë profesor Ramiut "Jetë të gjatë e shëndet së bashku me familjen e tij të mrekullueshme e suksese në studimet e ardhshme shkencore për gjuhën shqipe".

Më tej aktiviteti vijoi me këngë e shëndete, fotografi. Një moment shumë i

veçantë ishte edhe dhënia e Certifikatës "Mirënjohje e Kallaratis" dhënë nga shoqata Kallarati me motivacionin: "Për vlerat e çmuara si mësues e pedagog dhënë në fushën e arsimit për edukimin e brezave të tërë nxënësish e studentësh. Për kontributin si intelektual dhe akademik i shquar dhënë nëpërmjet studimeve e botimeve të shumta



në fushën e gjuhësisë, si dhe në media për mbrojtjen e gjuhës standarde shqipe në të gjitha trevat shqipfolëse. Për kontributin e dhënë për njohjen e historisë, kulturës dhe zakoneve të krahinës së Labërisë, në mënyrë të veçantë ndaj vendlindjes, shoqatës dhe gazetës "Kallarati", e cila profesor Ramiu i dorëzua nga kryetari i shoqatës "Kallarati", z. Kastriot Karaboli.

Profesor Ramiu në fjalën e tij falënderoi të gjithë pjesëmarrësit duke u ndjerë mjaft i emocionuar në këtë organizim të përsosur, duke vënë në dukje se njerëzit kanë nevojë të jenë të bashkuar, të njohin njëri - tjetrin dhe të festojnë së bashku si bashkëfshatarë, si miq e shok. Të njëjtat emocione përjetoi edhe bashkëshortja e tij, Adriana, e cila edhe ajo falënderoi të pranishmit dhe organizatorët e këtij takimi të bukur.

Të pranishmit me radhë që morën fjalën, vunë në dukje dhe vlerësuan lart kontributin e profesor Ramiut si gjuhëtar dhe në jetën shoqërore, ndaj vendlindjes dhe Labërisë.

Një vlerësim të veçantë bëri shkrimtari dhe gazetari Albert Zholi. Ai në përshëndetjen e tij theksoi se "Pa gjuhë nuk ka komb, një komb zhduket, kur i mohon gjuhën" dhe profesor Ramiu është një nga ata gjuhëtar që ka kontribuar me studime e botime të shumta shkencore që gjuha shqipe standarde të ruhet ashtu e pastër siç është vetë ajo. Ai solli edhe

një fakt shumë domethënës, gjatë kohës që kish qenë në Athinë, në një intervistë bërë prej tij, shkrimtarit të dëgjuar Aristidh Kola më 22 shtator 1998, duke e pyetur për gjuhën shqipe Aristidhi ishte shprehur: "Kjo gjuhë ka jetuar se ka patur gjuhëtar, ka patur atdhetar, ka patur patriotë, ka patur mendje të ndritura dhe njërin prej të tyre përmendi profesor Rami Memushaj".

Në aktivitet folën dhe përshëndetën profesorin edhe të tjerë si: Kastriot Karaboli, Lefer Hysi, Birçe Ribaj, Qemal Jonuzaj, Leonard Strataj, Artur Stratajt, Përparim Rrapaj, Kastriot Stratajt, Petrit Stratajt, Shkëlqim Kelo, Andon Pango, Gjergj Leskaj, Engjëll Bajrami, Besnik Strati, Bako Xhaferaj, Lukas i vogël, pasardhës i brezit të katërt Strataj, Luiza Gjonbrataj si ish studentja e tij në fakultet, Aranit Rjepaj, Bujar Memushaj, etj.

Një urim të veçantë bëri edhe gazetari Pano Hallko nga Vranishti, si ish nxënësi i tij dhe i bashkëshortes Adrianës, në shkollën 8 vjeçare "Hysen Çino" në Vranisht. "Profesor Ramiu - theksoi Panua - është pasuri kombëtare, ai është hartues i shqipes standarde, është personalitet në mbarë trevat shqiptare, ku flitet gjuha shqipe".

E veçanta e këtij takimi ishte edhe pjesëmarrja e më të moshuarës, zonjës Ismo

Golloshi, bashkëshortja e ish kryetarit të shoqatës "Kallarati", dega Tiranë, të ndjerit, Razip Golloshit, si dhe grave e femrave, bija e nuse kallaratase si: Resmie Ribaj, Natasha Strataj, Anila Xhaferaj, Alma Leskaj, Vefi Xhaferaj, Adriana Rjepaj, Luiza Gjonbrataj, të cilat me praninë e tyre i dhanë edhe më lezet e hijeshi takimit.

Këngët e kënduara nga këngëtarit kallaratas, Gjergji Leskaj dhe zagoriti Andon



Pango dhe të tjerëve e bën takimin mjaft të bukur e tërheqës.

Takimi u mbyll me një tortë nga shoqata "Kallarati" me mbishkrimin "Profesor Ramiu! Edhe njëqind vite të lumtura!"

Në shenjë respekti e mirënjohje gazetari dhe krijuesi Albert Zholi u dha pjesëmarrësve disa libra, botime të tijat si shkrimtar.

RAMI MEMUSHAJ

## SHQIPJA STANDARDE

Si të flisim dhe të shkruajmë

BOUTNET TOMA



# “ZËRI QË THEU QELQET E QIELLIT”

## MBASDITE HOMAZHI NË KUJTIM TË NJËVJETORIT TË NDARJES NGA JETA TË BILBILIT TË LABËRISË, BIRIT TË KALLARATIT, *HYSO BALIL XHAFERAJ*

**M**ë 25 shkurt në Tiranë nën drejtimin e “Mjeshtër të Madh”, Sokol Marsit, gazetarit të njohur Aleksandër Çipa, poetit Nexhip Onjea, aktorit Ervin Bejlerit, shoqatës “Kallaratit”, në një mbasdite homazhi të titulluar: “Zëri që theu qelqet e qiellit”, u përkujtua “Bilbili i Labërisë” dhe biri i Kallaratit, Hyso Xhaferaj në një vjetorin e ndarjes nga jeta.

Merrnin pjesë, familjarët, të afërm, miq, shok, artistë, këngëtar, muzikantë, gazetar, bashkëfshatarë kallaratas të Hyso Xhaferaj. Midis tyre do të veçonim këngëtarët e mëdhenj me të cilët Hysua këndoi përkrah tyre si: Hysni Zela, Irini Qirjako, kryetari i degës Tiranë të shoqatës “Labëria”, profesor Zaho Golemi, publicisti dhe shkrimtari i njohur, njëkohësisht kryeredaktor i gazetës “Labëria”, z. Albert Zholi, kryetari i shoqatës “Kallaratit”, z. Kastriot Karabollit, gazetarja e TV Neës 24, Anila Hamataj, përfaqësues të shoqatave të Fushëbardhës, Zagorisë, etj.

Takimi, me skenar të kompozitorit Sokol Marsit, u moderua nga aktori Ervin Bejleri, i cili në fjalën e tij të hapjes u shpreh: “Prej një viti të gjithëve na mungon fizikisht ky njeri sa i madh, aq edhe popullor, zemërgjerë e gojëmbël, familjar e shok shembullor, i mungon familjes, i mungon miqve, i mungon kolegëve, por i mungon edhe Kallaratit e gjithë Shqipërisë”.

Më tej u shfaq një video e shkurtër In Memorium Hyso Xhaferaj - “Zëri që theu qelqet e qiellit”, përgatitur nga kompozitori Sokol Marsi, njëkohësisht drejtor i Ansambllit të Këngëve dhe Valleve Popullore, ku në një formë tepër artistike u shfaqën pjesë nga këngët ku Hysua kishte kënduar, si me grupin “West Side Family”, me Irini Qirjakon e me grupe të tjera. E veçanta e kësaj video ishte zëri i vetë Hysos, ku rrëfente jetën e tij artistike, incizuar në vitin 2016.

Pastaj me radhë folën Aleksandër Çipa si mik familjar, duke e cilësuar Hyson një zë të rrallë, i cili duhet të studiohet nga muzikologët shqiptar. “Do të duhej me kohë të ndalej kushdo prej studiuesve të etnomuzikës dhe muzikologjisë tek ky zë, tek fenomeni vokale dhe interpretativ i një këngëtarit kaq unik...! Është një interpretues aq i hollë dhe me finesë magjike që tejkalon shamin interpretativ të çdo zonje arti. Zëri i këtij artisti sfidon instrumentet, (kryesisht violinën) dhe që magjishëm të fton dhe të shtyn në “lakun” e bukur të elementeve mistike njerëzore përmes tingullit zanor njerëzor. Hyso është zëri që të shkakton si ndjesi dhe perceptim, me çdo kordë dhe tingull, zanore dhe zgjatim të tij, asosacionin e përkryer të hapësirës dhe tejhapësirës në të cilën zgjatton njëzërëshin. Them është, sepse ai gjendet në amëshim, por zëri ka mbetur për një udhëtim të pakohë mes jetës së gjallë njerëzore..... Ky zë të lidh kryesisht me fijen e padukshme të shpirtit që shëtit nëpër pafundësinë eternale të qiejve dhe botëve - përfundoi fjalën e tij Aleksandri.



Këngëtarit Hysni Zela, i cili siç theksonte vetë Hysua, ishte i pari që dëgjoji e vlerësoi zërin e tij dhe që ndikoi për ardhjen në ansambllin shtetëror të këngëve dhe valleve popullore. Ja si shprehet Hysni Zela: “Kur e kam dëgjuar për herë të parë zërin e tij jam befasuara. Një zë i veçantë, i bukur, plot timbër, me një melodi të veçantë. U dashurova me zërin e tij. Se çfarë kishte diçka magjike ai zë! Kishte diçka që të mbërthente. Edhe unë si këngëtar u bëra fans i zërit të tij. Duke bashkëpunuar sa më shumë e njihja, aq më shumë. Befasohesha me cilësitë absolute të zërit të tij, Kam kënduar shumë këngë me Hyson. Sot mund të them me bindje se ai

bënte me të njëjtin nivel marrësin, prerësin, kthyesin apo dhe mbushësin me iso. Në shumë zëra unë mund ta dalloja menjëherë zërin e tij. Kishte një zë të pakrahasueshëm dhe studiuesve të këngës labe u takon ta studiojnë këtë zë. Nuk gjen fjalë shpirti më të ngrohta për ta përkufizuar melodinë e zërit të tij. Mbetet ndër zërat brilante të Shqipërisë. E kishte opsion këngën dhe mund të formonte tinguj të ndryshëm zëri sikur të ishte një instrument muzikor specifik. Madje me zërin e tij ai futej pa problem edhe në këngët e përpunuara. Ai hynte në zemrat e publikut pa marre leje. Zëra të tillë do i mungojnë Ansambllit të Këngëve dhe Valleve Popullore,

por sidomos këngës labe, që ai e deshi aq shumë. Ai edhe kur bisedonte patjetër që do fuste një varg kënge me zë ndryshe. Na mungon shumë” – përfundon këngëtarit i madh Hysni Zela.

Po kështu edhe Irini Qirjako, një nga këngëtarët e ansambllit, e cila në repertorin e saj ka shumë këngë labe dhe që ka dëgjuar e kënduar me shumë këngëtarë të polifonisë labe, u shpreh se “Hysua ishte një zë tepër i rrallë dhe i papërsëritshëm, që më mungon mua dhe që do t’i mungojë polifonisë shqiptare”.

Gjithashtu folën dhe shprehën vlerësime të veçanta, Sokol Marsi si kompozitor, por edhe si drejtues i ansambllit shtetëror të këngëve dhe valleve popullore, duke veçuar zërin e rrallë të Hysos e duke e quajtur atë gjeni që iku shpejt, por që do jetojë me këngën.

Kryetari i shoqatës “Labëria” dega, Tiranë, profesor Zaho Golemi, në fjalën e tij e vlerësoi Hyson, jo vetëm për këngën e talentin e tij të rrallë, por edhe si një mik i rrallë i Labërisë.

Edhe kryeredaktori i gazetës Labëria, gazetarit Albert Zholi në fjalën e tij vlerësoi me nota tepër të larta vlerat artistike të Hysos si këngëtar.

E veçanta e kësaj mbrëmje ishte pjesëmarrja e grupit lab “Bilbilat e Fushëbardhës”, të cilët kënduan në skenë këngën me tekst të poetit Nexhip Onjea “Mbetë degë trëndafil”, cila u mirëprit dhe u duartrokoi për emocionet që përcolli te familjarët e të pranishmit.

Në emër të shoqatës Kallaratit, z. Besnik Gjonbrataj duke dorëzuar familjes certifikatën “Mirënjohja e Kallaratit” në fjalën e tij ndërmjet të tjerash u shpreh: “Ditët, javët e muajt kaluan shumë shpejt, u mbush viti dhe akoma nuk e besojmë që “Bilbili i Labërisë”, biri i Kallaratit Hyso Xhaferaj, nuk është fizikisht mes nesh. Nuk e besojmë, sepse për ditë e më shumë kemi pranë zërin e tij të bukur e të veçantë, kemi portretin e tij të gjallë, kemi buzëqeshjen e fjalën e tij të ëmbël, të cilat na shoqërojnë kudo. Hysua me të vërtetë ishte nga Kallaratit, por ai nuk i përkiste vetëm atij, ai i përkiste Labërisë dhe më gjerë. Ai ishte një këngëtar me një zë të rrallë e të papërsëritshëm, ashtu siç e vlerësonte poeti i madh Lefter Çipa, “Nderi i Kombit” “Gur Xhevahiri, që me zërin e tij theu qelqet e qiellit”.

Hysua këndoi në mjaft skena brenda e jashtë vendit. Ai këndoi përkrah emrave të mëdhenj të muzikës popullore e të lehtë shqiptare si, me Hysni Zelën, me Irini Qirjakon e me Aurela Gaçen, me grupin e famshëm “West Side Family”, me Nazifin e grupin e tij, me Mimoza Kosturin e Zagorisë, me grupin “Vajzë e Valëve”, me grupin “Buronjat Labe”, “Antea”, “Zadeja” e në veçanti me këngëtarët e këngës labe, Mehmetin, Trifonin, Sotirin, Velon, Mihalin, Andonin, Paron, Goligun, Irfanin, Neilin, Agronin, Panon etj, të cilët do ta kishin Hyson mes tyre në çdo event e gëzim familjarë. Zanafillën si këngëtar Hysua e kishte marrë në vendlindje, si trashëgim nga i ati, Ballili, por që ishte ansambli, ky institucion



artistik, ku për 20 vjet Hysua u perfeksionua si këngëtar dhe shpalosi me dinjitet e profesionalizëm të lartë talentin e tij artistik, duke u bërë i njohur brenda e jashtë vendit. "Një zë unik në mbarë polifoninë shqiptare dhe një artist me vlera të jashtëzakonshme" do ta vlerësonte vetë ansambli.

Por Hysua jeton sot në këngët që u krijuan dhe u kënduan për të. Jeton me baladën e Nexhip Onjesë, interpretuar me mjeshtri nga aktori Bujar Asqeriu, "Nderi i Kombit", jeton në këngën e kënduar nga Nazif Çela e grupi po me tekst të Nexhip Onjesë, jeton në këngën e kënduar nga grupi i Vlorës me tekst të Sejmen Gjokolit, jeton në vajtimin e Zeqo Hoxhës, kënduar në festivalin e Bejkës së Bardhë në Pilur, por jeton edhe në këngën më të fundit me tekst të poetit Nexhip Onjea "Mbetë degë trëndafili", kënduar me pasion "Bilbilat e Fushëbardhës" në këtë mbasdite.

Vlerësimet për të janë të shumta, të cilat u përmblohdën në një numur ekstra të gazetës Kallarati, por mbi të gjitha spikat titulli i dhënë nga shoqata Labëria, "Personalitet i shquar i Labërisë", Labërinë që ai e deshi aq shumë dhe i këndoi me shpirt e pasion.

Më tej gjatë fjalës së tij, në emër të shoqatës falënderoi gjithë pjesëmarrësit, miq, shokë, këngëtar, artistë, drejtues të institucioneve shtetërore për praninë e tyre në këtë ditë homazhi për Hyso Xhaferaj, për vlerësimet e bëra për "Bilbilin e Labërisë", djalin e Kallaratis,



të shprehura aq bukur me mesazhe, me komente, me vargje, këngë, apo edhe sonte nëpërmjet kësaj mbasditeje homazhi për Hysua.

Hysua nuk i përkiste vetëm familjes, Kallaratis ku lindi, por gjithë Labërisë e Shqipërisë, së cilës i këndoi me shpirt e pasion, sepse ai përveç vlerave si artist, kishte vlerat si njeri, si një patriot e atdhetar i flaktë që e deshi shumë Labërinë dhe mbarë Shqipërinë. E për të gjitha këto ne si fshat ndihemi krenar për këtë artist me vlera të veçanta, për këtë bilbil që me zërin e tij e bëri edhe më të njohur Kallaratin. Prandaj ai me të drejtë meriton "Mirënjohjen e Kallaratis", certifikatë, të cilën shoqata ia dorëzon sot familjes së tij me motivacionin: "Për dashurinë ndaj vendlindjes, Kallaratis e krahinës së Labërisë, shprehur nëpërmjet këngës labe, interpretuar në nivelet më të larta artistike, si pjesë e Ansambli Shtetëror të Këngëve dhe Valleve Popullore dhe i shumë grupeve

muzikore e të polifonisë labe. Si bilbil i këngës labe, me zërin e vokalin e tij të veçantë e të papërsëritshëm, theu qelqet e qiellit në shumë skena brenda e jashtë vendit, duke na bërë krenar si fshat e krahinë. Hysua do të rrojë, sa të rrojë edhe vetë kënga labe".

Certifikata e mirënjohjes iu dorëzua djalit Fatjonit, i cili u duke marrë certifikatë pasi falënderoi pjesëmarrësit dhe organizatorët u shpreh se "Babai im Hysua e deshi shumë Kallaratin, por edhe Kallarati e nderoi me këtë certifikatë të veçantë".

Një mbasdite homazhi e veçantë për artistë të veçantë - u shprehën pjesëmarrësit, që rrallë bëhet në përmasa të tilla, por "Bilbili i Labërisë", e meritonte një kujtesë të tillë. "HYSUA DO RROJË, SA TË RROJË VETË KËNGA LABE"



NGA  
BAJRAM KARABOLLI

## PO IKËN BREZI I HEKURT, PËR T'I LËNË VENDIN BREZIT TË KRISTALTË

Brezi që pa ose me pak shkollë edukoi fëmijët e vet. Brezi që, pavarësisht mungesës së gjithçkaje, nuk lejoi kurrë që në shtëpi të mungonin gjërat e domosdoshme. Brezi që mësoi vlerat, duke filluar nga dashuria dhe respekti. Brezi që u mësoi burrave vlerën e grave dhe grave respektin për burrat. Po ikin ata që mundën të jetonin me pak luks, pa u ndjerë të mangët nga mungesa e tij. Ata që punuan që në moshë të re dhe mësuën për vlerën e gjërave, por jo për çmimin e tyre. Po ikin ata që kaluan një mijë vështirësi dhe, pa u dorëzuar, na mësuën si të jetojmë me dinjitet. Ata që pas një jete me sakrificë e vështirësi po largohen me duar të rrudhosura dhe me kokën lart.

Po ikin brezi që na mësoi të jetojmë pa frikë. Po ikin ti brez i dashur që na dhe jetë?!



# GËZUAR 7 MARSIN, “DITËN E MËSUESIT”

7 Marsi është një ditë e veçantë, ku të gjithë ne përulemi me respekt e mirënjohje përpara veprës Suaj të ndritur. Ju misionarë të njerëzimit që asnjëherë nuk u lodhët në përhapjen e diturisë, sot meritoni admirimin dhe dashurinë e gjithë botës.

Si kryesi e shoqatës na jepet rasti që sot t’ju drejtohem me një kartolinë urimi të gjithë mësuesve kallaratas ndër vite e t’ju themi, se keni qenë, jeni dhe do të mbeteni ata që përhapni reze drite e diturie, reze dashurie e atdhedashurie, jeni ata që përgatisni gjeneratat e reja, të cilët nesër do ta begatojnë këtë vend e do të realizojnë ëndrrën evropiane.

E gjithë mirënjohja për Ju sot shprehet mes vargjeshe e këngësh, të cilat nuk do të shterojnë kurrë.


Përulemi përpara veprës dhe madhësisë Suaj. Ky urim shkon për të gjithë mësuesit kallaratas, që ndër vite punuan me përkushtim për edukimin e brezit të ri në Kallarati dhe në gjithë Shqipërinë.

Urime dhe suksese gjithë atyre mësuesve kallaratas, që edhe sot ushtrojnë këtë profesion të bukur e fisnik! Mirënjohje e respekt të thellë gjithë atyre mësuesve kallaratas, që për vite të tëra ushtruan me kompetencë, profesionalizëm dhe dashuri profesionin e bukur të mësuesit dhe sot mund të ndodhen në pension, a në ndonjë punë tjetër! Mirënjohje dhe respekt gjithë atyre mësuesve jokallaratas, që krahas atyre vendas, punuan si mësues në shkollën 8-vjeçare “Mumin Selami” në Kallarati! Mirënjohje dhe homazh gjithë atyre mësuesve kallaratas, që sot nuk jetojnë më! Mirënjohje të thellë gjithë brezave të mësuesve shqiptarë, që kanë punuar dhe punojnë anembanë atdheut për edukimin e brezit të ri!

Në këtë 7 mars, për kujtesë le t’i përmendim me emra të gjithë mësuesit kallaratas dhe ata të ardhur, apo që punuan anembanë atdheut!

Mësuesve vendas: Telo Duro, Meçan Selami, Enver Golloshaj, Shelege Karabollaj, Sami Karabollaj, Servet Golloshaj, Namik Mehmetaj, Bilal Breshanaj, Proletare Habilaj, Dafina Qejvanaj, Burbuqe Qejvanaj, Kujtim Hysaj, Çize Xhaferaj, Violeta Xhaferaj, Hamit Muharremaj, Pranvera Hoxhaj, Altina Tozaj, Lefter Hysaj, Jazo Davacaj, Ferdinand Breshanaj, Thëllëza Hoxhaj, Donika Qejvanaj, Vojo Davacaj, Majlinda Davacaj, Gjinovefa Xhaferaj, Eglantina Demiraj, Enkeleda Hoxhaj, Vojsava Davacaj, Nezinete Davacaj, Selvi Mehmetaj, Altina Shakaj, Lindita Qejvanaj, Fiqirete Qejvanaj (Ramadani).

Mësuesve të ardhur nga rrethet e tjera dhe fshatrat e Vlorës: Jaho Hodo, Adem Hodo e Istref Pulo nga Borshi; Musa Sinani, Safet Gjoni e Remzi Mato nga Fterra; Xholito Gulielmo nga Italia; Jahja Seferi nga Kavaja; Liza Doda nga Shkodra; Kozma Llazari nga Lukova; Mërgim Korça nga Korça; Baki Abazi nga Tatzati; Nazif Duka, Fane Kongjini, Pranvera Shkurti, Vesel Habili e Mirjana Zeneli nga Vranishti; Gani Gana nga Mesapliku; Shaban Saliu, Xhafer Xhaferi, Xhevo Kaçaj, Emine Gjokutaj, Hysni Godaj, Eftimi Balili, Lumturi Godaj, Cane Fejzaj, Pikërimë Fejzaj, Naxhie Bishaj, Mersin Agaj, Kate Alikaj, Idajet Gjokutaj e Roneta Godaj nga Kuçi; Levzat Velaj, Mehmet Likaj, Nikollaq Dumani, Vangjel Bojaxhiu, Dhimitër Haxhiu, Shaban Mehmeti, Miranda Tushi, Neti Sollomani, Eli Ceko, Laureta Dhefto e Irma Mihali nga qyteti i Vlorës; Lefter Beqiri e Mird Sinaj nga Tërbaci; Vasil Tata e Leonidha Prifti



nga Kudhësi; Ëngjëll Hasimi e Shyqo Hasimi nga Armeni; Mareglen Ferraj e Shyqyrete Aliaj nga Brati; Viron Avduli nga Tragjasi; Qatip Veshi, Nezinete Leskaj, Lavdie Begaj, Feti Mezini, Izmimi Begaj, Ali Sadikaj, Kaçandon

Cacaj, Mylazim Sadikaj, Dritan Bajramaj, Ilir Sadikaj, Liri Sadikaj e Rajmonda Alikaj nga Bolena; Sonja Sadikaj nga Velça; Katerina Aliaj nga Selenica.

Mësuesve kallaratas që shërbyen

anembanë atdheut: Ardian Xhaferaj, Aferdita Xhaferaj, Aida Xhaferaj, Alfred Xhaferaj, Alketa Jonuzaj, Anila Golloshaj, Artur Hoxhaj, Barjam Karabollaj, Bashkim Gjonbrataj, Bejkush Karabollaj, Besnik Strataj, Bilal Shakaj, Çlirim Xhaferaj, Dallandyshe Jonuzaj, Dhurata Qejvanaj, Donika Qejvanaj, Elona Jonuzaj, Eneida Breshanaj, Entela Karabollaj, Fatbardha Strataj, Fatmir Mataj, Feride Shakaj, Gjinovefa Xhaferaj, Hadixhe Llanaj, Hasan Mehmetaj, Hiqmet Meçaj, Ibro Rjepaj, Ibrush Jonuzaj, Ilir Jonuzaj, Kastriot Xhaferaj, Klodiana Hoxhaj, Landi Golloshaj, Liljana Memushaj, Liri Qejvanaj, Llambro Hysaj, Luiza Hysaj, Luljeta Gjonbrataj, Lumturi Gjonaj, Maks Tozaj, Manushaqe Rjepaj, Marjeta Memushaj, Marjeta Hoxhaj, Oltosta Golloshaj, Petrit Qejvanaj, Qerime Meçaj, Rajmonda Dautaj, Rajmonda Shakaj, Rami Memushaj, Rita Shakaj, Selim Golloshaj, Servet Golloshaj, Shpresa Qejvanaj, Sonja Strataj, Fatbardha Strataj, Sulltane Rjepaj, Vitori Begaj, Xhiko Rjepaj, Yllka Golloshaj etj.

Kryesia e shoqatës “Kallarati”

“Urime dhe suksese gjithë atyre mësuesve kallaratas, që edhe sot ushtrojnë këtë profesion të bukur e fisnik! Mirënjohje e respekt të thellë gjithë atyre mësuesve kallaratas, që për vite të tëra ushtruan me kompetencë, profesionalizëm dhe dashuri profesionin e bukur të mësuesit dhe sot mund të ndodhen në pension, a në ndonjë punë tjetër!”



## GËZUAR 8 MARSIN, FESTËN E NËNËS!

Në këtë ditë të shënuar të “Nënës”, kryesia e shoqatës “Kallarati” u drejtohet gjithë grave, nënave dhe motrave kallaratase dhe mbarë shqiptare “Gëzuar festën e Nënës”. 8 Marsi, një ditë që mbart respekt, dashuri të pafund për nënat tona, për ato që na dhanë jetë nga jeta e tyre, për ato që natën e bënë ditë dhe na mekuan me qumësht nga gjiri i tyre, për ato që na gjenden pranë sado larg që të jemi, sa herë zemrat tona dëshpërohen, sa herë shpirtrat tanë rënkojnë. Është dita kur sot të gjitha lulet e botës, të gjitha urimet e përshëndetjet shkojnë për nënat. E gjithë dashuria derdhet lumë, sepse ato janë



dhe do të mbeten më të pazëvendësueshmet dhe më të shtrenjtat, për të gjithë njerëzit.

**Gëzuar gjithë nënave dhe motrave tona!**

Nga korrespondentja jonë në Kallarati, znj.

Eleni Memushaj informohemi se festa e nënës në Kallarati u festua me pjesëmarrjen e të gjitha grave pa dallim moshe në klubin e Zeqo Hoxhës në një


atmosferë tepër festime, ku u mbajt fjalë përshëndetëse nga znj. Bejaze Qejvani, u kënduan këngë labe e u kërcye nën ritmin e këngëve popullore. Gatimi ishte bërë në klubin e Zeqos, por edhe me gatime tradicionale nga vetë gratë. Secilës grua iu dhurua një buqetë me lule.



NGA PROF. DR.  
RAMË MEMUSHAJ

# KUVENDI I LABËRISË MBI HAKMARRJEN

(Një dokument i rrallë)



për t'u marrë vesh. Nga 11 pleq, shkuan 7, të cilët ranë në pusinë që u ishte ngritur, dhe 6 prej tyre u vranë. Çështja mbeti pezull, 11 me 6 vrasje, që do të thoshte se gjakderdhja do të vazhdonte.

Mirëpo ishte kohë lufte me pushtuesin dhe kanuni i Labërisë kishte një normë që e ndalonte hakmarrjen në kohë lufte, normë që u zbatua gjerësisht gjatë Luftës Antifashiste. Kështu që po këtë vit, për të ndaluar gjakderdhjen, u thirr një kuvend i pleqve të Kurveleshit, Bregdetit dhe të Rrëzomës. Kuvendi u mblodh në lumë të Sasajt, po nuk arriti të merrte një vendim të detyrueshëm për të dy fshatrat, sepse ditën e mblodhjes piluriotët u hakmorën duke vranë e plagosur disa sasaj.

Për të shuar armiqësinë midis dy fshatrave, u mblodh një kuvend i dytë në Kudhës të Himarës më 28 mars 1943. Ishte koha kur lëvizja antifashiste kishte marrë formë të organizuar dhe pushteti i organeve vendore ishte fuqizuar. Ky kuvend mori një vendim, që me sa dimë, u zbatua. Vendimi u hodh në letër, "u redaktua e u lexua me zë të lartë, u dëgjua prej të gjithëve, u pëlqye dhe u nënshkrua" nga pleqtë e fshatrave pjesëmarrës.

Originali i këtij vendimi ka qenë ruajtur në muzeun e Qeparoit. Nuk dihet a ka shpëtuar ky dokument nga shkatërrimet e 1997-s, po, për fat, Llambro Varfi nga ky fshat i pati bërë një kopje më 10 prill 1995. Këtë kopje, për të cilën Llambro shkruan në shënim "Kopjuar sipas origjinalit", po e botojmë si një dokument të rrallë për kuvendet, që ishin organi më i lartë vendimmarrës në krahinat e vetëqeverisura. Por edhe për të parë se cilat ishin pikat e vendimit, cilat ishin detyrimet e palëve në konflikt dhe të fshatrave pjesëmarrëse në kuvend dhe, më në fund, për të parë se Kallarati kishte një zë në këto kuvende të Labërisë.

Labëria ka qenë një nga krahinat e vetëqeverisura të Shqipërisë. Të drejtën e vetëqeverisjes ajo e fitoi në vitin 1492, kur himarjotët e detyruan sulltan Bajazitin, që erdhi vetë në krye të ushtrive të mëdha për të shtypur kryengritjen e madhe të atij viti, të pranonte që krahina e Himarës (kështu quhej Labëria deri në fund të shekullit të 18-të) të qeverisej me kanunin e vet. Kanuni i Labërisë, ashtu si kanunet e malësive të Veriut, është një tërësi ligjesh e normash të pashkruara, të trashëguara brez pas brezi, që janë të detyrueshme për banorët e krahinës. Ai mbeti ligji i vetëm i Labërisë deri në fund të pushtimit osman, po edhe gjatë dy luftërave botërore, kur shteti kishte rënë ose kur ishte vënë në shërbim të pushtuesit, siç ndodhi gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Njëra ndër normat e shumta të kanunit është ajo për mbrojtjen e të huajit që shkelte në një fshat. Në këto raste, i huaji (mik, punëtor, kalimtar) ishte në besë të fshatit. Kur një banor i fshatit vriste të huajin që ishte në dorë të fshatit, atëherë fshati duhet ta dënonte vrasësin me vdekje. Një rast i tillë përshkruhet në librin "Kanuni i Labërisë", të përgatitur për botim nga profesori fterriot Ismet Elezi.

Në vitin 1941, në mal të Sasajt, djali i S. P. nga ky fshat vrau Foto Priftin nga Piluri me gjithë familje (dhjetë veta), një bari nga Borshi dhe qenin e stanit e i mori dhentë. I vëllai i viktimës, Savo Prifti, që ishte i burgosur në Burrel, si u kthye në Pilur, i dërgoi fjalë Sasajt se vrasësi i vëllait ishte nga fshati i tyre dhe kërkoi të zbatohet kanuni, d.m.th. ta gjenin vrasësin dhe ta vritnin. Po Sasaj iu përgjigj se vrasësi nuk ishte nga ai fshat. Atëherë Savua ftoi pleqtë e Sasajt që të vinin poshtë fshatit

## Nga Besnik Gjonbrataj

Ashtu si vite më parë kur doje të takoje dikë në Vlorë, do të dëgjoje shprehjen "Takohe mi te Kapelja", tani për kallaratasit dhe jo vetëm dëgjojmë shprehjen "Takohe mi te Andoni", që nënkupton menjëherë mishin e pjekur në hell. Kështu ndodhi edhe këtë herë me njoftimin e shoqatës për festimin e 20 vjetorit të krijimit të saj "Takohe mi te Andoni". Dhe me të vërtetë u takuam te Andoni dhe nuk u zhgënjëm dhe kjo falë bujarisë e mikpritjes së Andon Bejkush Leskaj (Laçaj).

Andoni prej disa vitesh ka ngritur biznesin e tij privat familjar në qytetin e Vlorës me tregtimin e mishit të pjekur në hell sipas traditës së labërisë, traditë kjo e trashëguar nga i ati, Bejkushi, një nga blegtorët e dëgjuar kallaratas. Jo më kot restorantit të tij i ka vënë emrin "Mish i pjekur Labërie". Lokali gjendet diku në qendër të Vlorës, tashmë vendodhja e tij dihet nga të gjithë. Klientela e tij janë, jo vetëm kallaratasit, por nga gjithë zona e Labërisë. Mënyra e të gatuarit, pastërtia, shërbimi nga stafi mjaft i kulturuar, çiltërsia, bujaria dhe humori i vet Andonit, pa harruar edhe këngën labe, e bëjnë këtë lokal mjaft të preferuar, saqë vlonjatët, kur duan të takohen diku, prej tyre dëgjon shprehjen "Takohe mi te Andoni".

Prej vitesh ky lokal shërben edhe si strehës



për shoqatën Kallarati, jo vetëm për të kaluar një drekë të këndshme, por edhe për të bërë mbledhje dhe kjo falë bujarisë, mikpritjes dhe dashurisë që të afron i zoti i shtëpisë, Andoni



dhe gjithë stafi i tij familjar, bashkëshortja Alma, dy çunat Aureli dhe Orgesi, e të tjerë të punësuar.

Kështu ndodhi edhe të dielën që sapo

kaluam, ku shoqata Kallarati festoi 20 - vjetorin e krijimit të saj, pikërisht në lokalin e Andonit, ku u krijua një atmosferë mjaft e bukur e festive, ku përveç fjalimeve e ndarjes së disa certifikatave "Mirënjohje e Kallarati", aktiviteti vijoi me këngë e dolli, ku pjesë e këtij gëzimi u bë edhe vetë Andoni. Në shoqërinë e të vëllait, Gjergji Leskaj tashmë këngëtar i njohur, Aranit Rjepaj, por edhe të zagoritit Andon Pangos, po harruar talentin e ri, vogëlushin Lukas Strati e pjesëmarrësve të tjerë, buçiti kënga labe e u ngritën dollitë, si rrallëherë në këtë lokal në zemrën e Vlorës. Por mikpritja dhe bujaria e tij familjare arriti kulmin kur Andoni, deklaroi: "Gjithçka që sot do të shërbehet në lokalin tim, është falas, prandaj mos u kurseni. Për mua - vazhdoi Andoni - është kënaqësi që zgjodhët për të festuar 20 - vjetorin e krijimit të shoqatës, pikërisht në lokalin tim. Secili sipas mundësisë duhet të bëjë diçka për vendlindjen. Mua sot m'u dha mundësia të prisja bashkëfshatarët e mi në shtëpinë time sipas traditës së Kallaratis me mish, raki e këngë" - përfundoi Andoni fjalën e tij. Si kryesi e shoqatës e falënderojmë Andonin familjarisht për mikpritjen dhe kontributin financiar, dhënë ndaj shoqatës, jo vetëm në këtë rast, por edhe në shumë aktivitete të tjera dhe në të njëjtën kohë i urojmë veç suksese.

**Mos harroni! Do takohe mi përsëri te Andoni...**

Fisi Strataj i Kallaratis është mjaft i gjerë dhe i njohur, i cili në kohë e momente të ndryshme të historisë së Kallaratis, ka kontribuar ndaj vendlindjes dhe jo vetëm me pushkë e penë, por edhe me këngë. Ai sot është i shpërndarë gjithandej: në Vlorë, Selenicë, Fier, Tiranë dhe pas viteve 90-të në të gjithë botën, kryesisht në Greqi, Itali, Gjermani, Angli, Austri e deri në Amerikë. Pa u ndalur me hollësi për këtë fis, kalimthi do të përmendim vetëm dy personazhe të këtij fisi, për të dalë te objekti i këtij shkrimi, që është LUKASI I VOGËL I pari është Enver Strataj, i cili para se të ndahej nga jeta plotësoi një dëshirë dhe ëndërr të tijën duke lënë si kujtim për gjithë kallaratasit librin e tij “Historiku i Kallaratis” dhe së dyti piktorin Saimir Strati, që nuk di të ndalojë për asnjë çast nga puna për fitimin e çmimit Guinness, çmim i cili tashmë është bërë “pronë” e tij. Por sidoqoftë këta i përkasin brezave të dytë e të tretë të këtij fisi, pasi një tjetër person, vazhdues i denjë i këtij fisi, i brezit të katërt do t’a quanim, me dashurinë që tregon ndaj vendlindjes së stërgjyshit të tij, Enver Stratit, kërkon të bëjë emër dhe ky është Lukas Strataj, i datëlindjes 29 shtator 2013, nxënës shembullor në klasën e 3-të të shkollës jopublike “Viktor Hygo”, Tiranë, djalë i dy prindërve me profesion arkitekt, ku arti dhe shkenca janë dy elementë që e kanë formuar edhe Lukasin që në vogëli.

Lukas është një djal multi-disiplinar, i prirur në shkenca ekzakte, i apasionuar në disiplina sportive, me ndjeshmëri artistike në fushën e artit, me dëshirë për të guxuar në eksperiencën televizive.

Lukasi është një djal i ndjeshëm, i edukuar, me një buzëqeshje të ëmbël dhe plot ëndërra dhe dëshira. Lukas, ky artist i vogël i gjeneratës “Strataj” është djali i Duljan Strataj, nipi i Kastriot Strataj e stërnipi i Enver Strataj, Ashtu si trashëgimtarët e familjes “Strataj” edhe Lukasi i pëlqen historiku i vlerave dhe kulturës së trashëguar të kësaj familje dhe me shumë dëshirë për ta çuar edhe më tej këtë mbiemër, në nder të babait, gjyshit, stërgjyshit dhe brezave të nderuar të kësaj familjeje.

Lukasi është edhe anëtar i ri dhe ndër më aktivët e shoqatës “Kallarati”, dega Tiranë, por edhe një dashamirës i apasionuar i këngës labe. Ai ishte i pranishëm në Vlorë më 15 janar në festimin e 20 - vjetorit të krijimit të shoqatës “Kallarati” përkrah gjithë Stratajve të tjerë dhe këndoi labçe me Gjergji Leskaj, Andon Pangon, Arjanit Rjepaj, Andon Leskaj, e të tjerë të pranishëm dhe aktiv ndaj këngës, ashtu siç ishte edhe në aktivitetin tjetër në Tiranë në festimin e 80 - vjetorit të lindjes të Profesor Rami Memushaj, të cilit në emër të pjesëmarrësve i dorëzoi atij buqetën me lule. Si duket Lukasin kënga labe e tërheq shumë, dëshiron të bëjë rolin e marrësit të këngës, por të bëhet edhe një njeri i ditur si vetë profesori.

Si Lukasi ka plot nipër e mbesa të Kallaratis që e kanë për krenari të njohin vendlindjen apo origjinën e gjyshërve e stërgjyshërve të tyre, pavarësisht ku kanë lindur e ku jetojnë, edhe ata e quajnë veten e tyre kallatatas.

Duke përshëndetur e uruar suksese “Lukasit të vogël” të fisit Strataj, përshëndesim gjithë ata fëmijë kallaratas anëmbanë botës, duke u kujtuar atyre moton tashmë të njohur “Ec ngado po Kallaratin mos e harro”!

# “LUKASI I VOGËL”, VAZHDIUES I DENJË I GJENERATËS “STRATAJ”



## IN MEMORIAM

### NDAHET PARA KOHE NGA JETA VIKTOR MYRDAR BRESHANAJ

Pas një sëmundje të rëndë, më datën 4 shtator 2022, në Tiranë, u nda para kohe nga jeta, Viktor Breshanaj. Viktori u lind më 25 dhjetor 1958 në Selenicë, Vlorë nga prindërit Myrdar e Shefo Breshanaj (Laçaj) me origjinë nga Kallarati i Vlorës, familje kjo e njohur për ndjenjat patriotike e atdhetare dhe dashurinë ndaj vendlindjes. Pas përfundimit me sukses të Shkollës së Ministrisë së Brendshme, Viktori për shumë vite punoi me përkushtim e devotshmëri në rrethin e Gramëshit. Mbas viteve demokracisë, me mund e djersë krijoi biznesin e tij privat, duke qenë mjaft i suksesshëm. Por sëmundja e rëndë, me gjithë përpjekjet e familjes e të kurimit jashtë vendit, e ndau atë para kohe nga familja e tij e dashur, nga bashkëshortja, dy fëmijët, vëllai e motra, nga të afërmit, miqtë e shokët e tij të shumtë, por edhe nga ne bashkëfshatarët e tij kallaratas. Sëmundja i preu në mes ëndrrat e tij ndaj familjes e shoqërisë. Kryesia e Shoqatës Kallarati, i shpreh familjes, bashkëshortes, dy fëmijëve, vëllait, motrës, të afërmeve, gjithë fisit Breshanaj, ngushëllimet më të thella e të sinqerta për humbjen e parakohshme të njeriut të tyre të dashur! Qoftë i paharruar kujtimi i Tij! U prehtë në Paqe!



## IN MEMORIAM

NDAHET NGA JETA DYLBERE  
KARABOLLAJ (LESKAJ)

Pas një sëmundje të rëndë, më 29 nëntor 2022, në Tiranë u nda nga jeta Dylbere Karabollaj, bashkëshortja e Tare Karabollaj (ndarë nga jeta), nëna e Elisabeta e Ludmilla Karabollaj, vjehrra e Aleksandër Çalës. Dylberja lindi në Bolenë të Vlorës më 5 janar të vitit 1938 në familjen e Arshi Abedinit/Leska, familje e njohur për patriotizmin dhe ndjenjën e lirisë. Ajo ishte motra e vogël e Shukos dhe Dilaverit, të dy ushtarakë të nderuar. Fëmijërinë Dylberja e kaloi në Shtëpinë e Fëmijës në Vlorë, pasi mbeti që e vogël jetime. Në vitin 1956 martohet në fisin e dëgjuar Karabollaj në Kallarat me Tare Karabollaj, ish partizan dhe më vonë oficer i Ushtrisë Popullore dhe vendosen në Tiranë. Ata lindën, rritën dhe edukuan dy vajza të mrekullueshme, Elisabetën (ish kampionen e Evropës në qitjen me pistoletë) dhe Ludmillën. Familja e tyre në Tiranë e kishte derën e shtëpisë të hapur për çdo kallaratas e bolenas, duke qenë mjaft bujare e mikpritëse. Ata ishin të lidhur me vendlindjen e tyre duke dhënë ndihmesë të vyer në edukimin patriotik e atdhetar të brezave të rinj. Me vajzën e tyre Elisabetën, bënë krenar çdo shqiptar, aq më tepër në kallaratasit, që mburreshim dhe ndiheshim krenar për rezultatet e saja në sport. Dylberja pati punuar si ekonomiste në ndërmarrje dhe institucione të ndryshme në Tiranë, deri sa doli në pension. Kudo ku punoi ajo kujtohet sot si një specialiste e zonja dhe njëri me virtyte të larta duke lënë emër të mirë. Kryesia e shoqatës Kallaratit u shpreh ngushëllimet më të thella e të sinqerta dy vajzave Elisabetës e Ludmillës, nipërve e mbesave, të afërmve, fisit Leskaj në Bolenë e Karabollaj në Kallarat. Qoftë i paharruar kujtimi i Saj! U prehtë në Paqe!



## IN MEMORIAM

NDAHET NGA JETA HAMIT  
HADËR MUHARREMAJ

Më 11 shkurt 2023 u nda nga jeta në moshën 89 vjeçare mësuesi veteran Hamit Muharremaj, bashkëshorti i Dritës (ndarë nga jeta), babai i Pajtitimit, Antonetës, Teftës (ndarë nga jeta) e Bardhi Muharremaj. Hamiti u lind në Kallarat më 1 janar 1934 në një familje me ndjenja patriotike dhe atdhetare. Ai është një nga mësuesit më të vjetër të Kallaratit të pas luftës, që kontribuoi për vite të tëra në edukimin dhe arsimimin e brezave të tërë nxënësish në shkollën "Mumin Selami" në Kallarat, por për disa vite edhe në Ploçë, Bolenë e Kunjovë. Mësues Hamiti i takon brezit të pionierëve të arsimit shqiptar që punuan me vetmohim zell e dashuri për arsimimin dhe edukimin brezave të tërë nxënësish. Të gjithë ata kallaratas dhe jo vetëm që e patën edukator, do ta kujtojnë me respekt mësuesin e tyre. Për kontributin e tij në arsim, por edhe në jetën shoqërore, mësues Hamiti ishte vlerësuar me medalje e certifikata të ndryshme. Në vitin 2016 në kuadrin e 100 vjetorit të çeljes së shkollës së parë shqipe në Kallarat, me propozim të shoqatës Kallaratit, nga Bashkia e Himarës iu dha certifikata me motivacionin "Për kontribut në fushën e mësuesisë dhe edukimit të brezit të ri". Kryesia e shoqatës Kallaratit u shpreh ngushëllimet më të thella e të sinqerta Pajtitimit, Antonetës, Bardhit, nipërve e mbesave e të afërmve. Qoftë i paharruar kujtimi i Tij! U prehtë në Paqe!



## IN MEMORIAM

## NDAHET PARA KOHE NGA JETA DASHNOR XHEMAL STRATAJ

Më 1 janar 2023 në Tiranë, pas një sëmundje të rëndë është ndarë para kohe nga jeta në moshën 60 vjeçare, Dashnor Strataj, djali i Xhemal e Hurma Strataj, bashkëshorti i Brunës, babai i Xhejnit dhe i Juljanit, vëllai i Petritit, Natashës dhe Leonard Strataj. Nori u lind më 29 nëntor 1962 në qytetin e Fierit nga prindërit Xhemal e Hurma Strataj me origjinë nga Kallaratit i Vlorës. I rritur në një familje të tillë me ndjenja të theksuara patriotike dhe atdhetare, ashtu si motra e vëllezërit e tij, edhe Nori u rrit me frymën e dashurisë e të respektit për familjen, të afërmit dhe njerëzit në përgjithësi. Nori, pasi mbaroi shkollën e mesme, për disa vite punoi në sektor të ndryshëm të shërbimeve në Fier, duke treguar përkushtim, korrektësi dhe dashuri për punën. Pas viteve 90-të, Nori ashtu si edhe shumë të tjerë, të detyruar nga papunësia e krijuar, me mund e djersë krijoi biznesin e tij privat, por duke mos lënë pas dore angazhimet e tij në zhvillimet shoqërore në qytetin e Fierit. Në vitin 1989, Nori u martua e krijoi familjen e tij me Brunildën me origjinë nga Përmeti, vajzë e prindërve të nderuar Osmënaj, me të cilën lindën, rritën, shkolluan dy fëmijë të mrekullueshëm, vajzën Xhejnin dhe djalin Juljanin. Edhe pse në moshë të re, Nori arriti t'i martojë të dy fëmijët, Xhejnin me Alen Shkrelin dhe Juljanin me Iridën, të cilët me djalin e tyre të vogël i dhanë Norit statusin e gjyshit. Nori i donte shumë prindërit e njerëzit e tij të

afërm, prandaj vitet e fundit e shpërnguli biznesin e tij privat në Tiranë, për të qenë edhe më pranë prindërve të tij, vëllait të tij të dashur, por edhe fisit të madh Strataj të Tiranës. Por këtu ai përjetoi edhe ndarjen nga jeta të babait të tij, Xhemal Strataj e të xhaxhait Enver Strataj, në kohën më të vështirë, atë të luftës ndaj pandemisë së COVID-it. Nori i donte njerëzit, e donte familjen, i donte dhe i respektonte të afërmit, miqtë e shokët e tij e të familjes. Nori e donte qytetin e tij, Fierin, por Nori donte shumë edhe vendlindjen e prindërve të tyre, Kallaratit, ku do të ishte i pranishëm çdo verë te njerëzit e tij të afërm të fisit Strataj e Ribaj, te gjyshja, te dajua e tezet. Nori ishte mishërim i dashurisë, urtësisë, i qetësisë dhe i humorit. Fjala e tij e ëmbël mbarte vetëm paqe. Në kohën që Nori kishte plotësuar më së miri detyrimet e tij familjare, në kohën më të mirë që duhej ta jetonte së bashku me bashkëshorten dhe fëmijët, sëmundja e rëndë u tregua e pamëshirshme duke marrë para kohe Norin tonë të dashur e gojëmbël dhe e ndau atë para kohe nga gjiri i familjes dhe i shoqërisë, duke lënë vetëm shoqen e jetës, Brunildën, vajzën Xhejnin, djalin Juljanin, të cilët i donte aq shumë, nënën Hurmanë, e cila në këtë moshë nuk duhej të përballej me këtë fatkeqësi, duke pikëlluar pa masë motrën, vëllezërit e duke na hidhëruar të gjithë neve. Kryesia e shoqatës "Kallaratit" u shpreh ngushëllimet më të thella e të sinqerta familjes, nënës, bashkëshortes, fëmijëve, vëllezërve, motrës, të afërmve dhe fisit Strataj për këtë humbje të madhe. Qoftë i paharruar kujtimi i tij! U prehtë në Paqe!



## IN MEMORIAM

NDAHET NGA JETA  
QERIME ARAPI (MEÇAJ)

Më 17 janar 2023 u nda nga jeta në moshën 75 vjeçare, Qerime Arapi (Meçaj), bashkëshortja e Sali Arapit (ndarë nga jeta), nëna e Enel e Anita Arapit, motra e Gafur dhe Hiqmet Meçaj.

Qerimja u lind në vitin 1946 në Vlorë nga një familje kallaratase e njohur për ndjenjat patriotike e lirisdashëse, nga prindërit Hasan e Kaleme Meçaj. Qerimja në vitin 1973 përfundoi universitetin shtetëror të Tiranës në degën Gjuhë - Letërsi dhe për shumë vite punoi me përkushtim në arsim në shkollë të ndryshme të qytetit të Fierit dhe Vlorës, duke marrë vlerësime të ndryshme si një mësuese dhe intelektuale e dalluar në edukimin e brezit të ri. Ajo u martua me inxhinierin Sali Arapi, me të cilin lindën, edukuan dhe arsimuan dy fëmijë të mrekullueshëm, djalin Enel Arapin, mjek dhe vajzën Anita Arapi, juriste. Sëmundja e rëndë e ndau Qerimen nga fëmijët, nipërit dhe mbesat, si dhe të afërmit e fisit Arapi dhe Meçaj. Kryesia e shoqatës "Kallaratit" u shpreh ngushëllimet më të thella e të sinqerta familjes dhe të afërmve. Qoftë i paharruar kujtimi i saj! U prehtë në Paqe!



## IN MEMORIAM

NDAHET PARA KOHE NGA  
JETA SOKOL ZOTO RJEPAJ

Më 19 mars 2023 u nda nga jeta para kohe në moshën 53 vjeçare, Sokol Rjepaj me origjinë nga Kallaratit dhe banim në Tiranë, djali i Zoto e Lela Rjepaj (ndarë nga jeta), bashkëshorti i Valbonës, babai i dy vajzave Irisit dhe Emës, vëllai i dy motrave Albës dhe Monkës. Sokoli u lind në Tiranë më 21 Mars 1970 në një familje me tradita patriotike dhe atdhetare. Ai kishte mbaruar universitetin e Tiranës, dega Filozofi. Si i ri dhe me ide demokratike Sokoli në vitet 90-të ishte një nga studentët e grevës së urisë që kontribuoi për ardhjen e demokracisë në Shqipëri. Gjatë jetës së tij Sokoli ka kryer me devotshmëri e përkushtim detyra të ndryshme dhe kohët e fundit ishte drejtor i shitjeve tek kompania Rjepaj Elektromekanika shpk Tiranë. Sëmundja e rëndë dhe e menjëhershme e ndau atë para kohe nga jeta, nga familja dhe shoqëria. Kryesia e shoqatës Kallaratit u shpreh ngushëllimet më të thella e të sinqerta familjes për këtë humbje të parakohshme të njeriut të tyre të dashur. Qoftë i paharruar kujtimi i Tij! U prehtë në Paqe!



# *Ec ngado* **KALLARATIN** mos e harro!



**Kryeredaktor:**  
Lefter HYSAJ

#### Redaksia e Gazetës:

Anëtarë:  
Prof. dr. Rami MEMUSHAJ,  
Hiqmet MEÇAJ,

Fatmir MATAJ,  
Çize XHAFERAJ,  
Eleni MEMUSHAJ,

Besnik GJONBRATAJ,  
Riza MEMUSHAJ,  
Selo QEJVANI.